

Raporti përfundimtar i vlerësimit

Vlerësim i mbështetjes së financuar nga BE ofruar Kuvendit të Kosovës Shtator 2018 - Dhjetor 2018

Kontratë kornizë EuropeAid/138778/DH/SER/Multi
Pjesa 3: Të Drejtat e Njeriut, Demokracia dhe Paqja
Letër e kontratës N° 2018/399707
Përgatitur nga: EuroPlus Consulting & Management
Franklin De Vrieze
Paraqitur në dhjetor, 2018

Ky raport është përgatitur me ndihmën financiare të Komisionit Evropian. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të konsulentëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Komisionit Evropian

EuroPlus
Consulting & Management

Konsorciumi Particip përbërë nga: Particip GmbH në bashkëpunim me AAH, AOA, ADE, Cardno, Coffey, DIIS, DRC, ECDPM, EPRD, Europlus, Maxwell Stamp, NCG, SICI DOMINUS, Tana, WYG

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	6
1 Hyrje	13
1.1 Kuvendi i Kosovës	13
1.2 Përshkrim i veprimit	14
1.2.1 Objektivat dhe rezultatet e tri projekteve	14
1.2.2 Përfituesit e synuar dhe akterët e tri projekteve	15
1.2.3 Metodologjia e projekteve të binjakëzimit parlamentar	15
1.3 Objektivat e detyrës së vlerësimit	15
1.4 Metodologjia e vlerësimit	16
1.4.1 Hipotezat e vlerësimit	16
1.4.2 Qasja gjithëpërfshirëse.....	16
1.4.3 Vlerësimi mbi realizimin e programit	17
1.4.4 Vlerësimi teknik për temat e projektit	17
1.4.5 Cilësia dhe zbatimi i rekomandimeve.....	17
1.4.6 Mbledhja e të dhënave	18
1.4.7 Sfidat e vlerësimit	18
2 Pyetjet dhe përgjigjet e vlerësimit	19
3 Vlerësimi mbi realizimin e programit	27
3.1 Dizajni i projektit.....	27
3.1.1 Ndërlidhja	27
3.1.2 Përzgjedhja e instrumenteve zbatuese	27
3.1.3 Renditja dhe fushëveprimi i projekteve	27
3.2 Zbatimi i projektit.....	28
3.2.1 Vlerësimi i rezultateve	28
3.2.2 Vlerësimet e hollësishme	28
3.2.3 Ndërtimi i kapaciteteve	28
3.2.4 Fleksibiliteti dhe përshtatja	29
3.2.5 Rrjeti ndërparlamentar.....	29
3.2.6 Rekomandimet për ndryshime	29
3.2.7 Plani i Veprimit	30
3.3 Menaxhimi i Projektit.....	32
3.3.1 Mbështetja në natyrë.....	33
3.3.2 Monitorimi i brendshëm dhe Komiteti Drejtues.....	33

3.3.3	Ekspertët Afatshkurtër.....	33
3.3.4	Angazhimi politik	34
3.3.5	Raportet me projekte të tjera donatore.....	34
3.3.6	Përfshirja e Zyrës së BE-së në projekt.....	35
4	Vlerësimi teknik i temave të programit	37
4.1	Pavarësia për Kuvendin e Kosovës	37
4.1.1	Draft Ligji për Kuvendin	37
4.1.2	Projektligji në pritje	38
4.2	Legjislacioni në Kuvendin e Kosovës.....	40
4.2.1	Procesi legjislativ në parlament.....	40
4.2.2	Dokumentimi qeveritar i projektligjeve.....	42
4.2.3	Deklarata e harmonizimit dhe Tabelat e Pajftueshmërisë.....	42
4.2.4	Njësia për përafrimin e legjislacionit me Acquis-in e BE-së	43
4.2.5	Konsolidimi i legjislacionit.....	44
4.2.6	Praktika e miratimit të përsheptuar të legjislacionit.....	45
4.2.7	Sistemi i gjurmimit të legjislacionit.....	45
4.2.8	Funksionimi shumëgjuhësh i kuvendit.....	46
4.2.9	Dy doracakë legjislative.....	46
4.3	Menaxhimi financiar, in BNJ-së dhe TIK-ut në Kuvendin e Kosovës.....	47
4.3.1	Menaxhimi financiar dhe buxhetor	48
4.3.2	Burimet njerëzore	49
4.3.3	Sistemi i Informacionit dhe Komunikimit.....	51
4.4	Mbikëqyrja nga Kuvendi i Kosovës	52
4.4.1	Mbikëqyrja e qeverisë	52
4.4.2	Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura	54
4.5	Fuqizimi i Komisionit për Integritet Evropian dhe i Komisioneve të tjera lidhur me procesin e MSA-së	56
4.5.1	Roli dhe funksionimi i Komisionit për Integritet Evropian	57
4.5.2	Komisioni Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim BE-Kosovë	58
4.5.3	Fuqizimi i përfshirjes së komisioneve të tjera në procesin e MSA-së.....	58
4.5.4	Roli i Kuvendit në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme për çështjet e BE-së.....	59
4.6	Mbështetja administrative për deputetët lidhur me detyrat në procesin e integritet evropian	59
4.6.1	Zhvillimi i strukturave administrative përgjegjëse për detyrat e integritet në BE.....	60
4.6.2	Strategjia për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe bashkëpunimin ndërparlamentar lidhur me MSA-në.....	61

4.6.3	Përmirësimi dhe avancimi i aktiviteteve hulumtuese.....	61
5	Konkluzione dhe rekomandime.....	63
5.1	Konkluzione	63
5.2	Rekomandimet.....	65
	Annex 1: Terms of Reference of the evaluation	70
	Shtojca 2: Profili i vlerësuesit.....	82
	Shtojca 3: Lista e bashkëbiseduesve, misioni i vlerësimit, tetor 2018.....	83
	Shtojca 4: Literatura e konsultuar.....	85
	Shtojca 5: Tabela e analizës së cilësisë dhe statusit të zbatimit të Planit të Veprimit.....	86

Falënderim dhe mohim i përgjegjësisë

Ky vlerësim mbështetet dhe udhëhiqet nga Komisioni Evropian dhe prezantohet nga konsorciumi i udhëhequr nga Particip duke përfshirë Europlus Consulting and Management. Raporti i vlerësimit është përpiluar nga Franklin De Vrieze. Pikëpamjet e shprehura janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e Bashkimi Evropian.

Akronime

KK	Kuvendi i Kosovës
KIE	Komisioni për Integritet Evropian
SPIMJ	Sistemi i Përbashkët i Informimit për Marrëdhënie të Jashtme (Komisioni Evropian)
OSHC-të	Organizatat e Shoqërisë Civile
DPMN	Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
KE	Komisioni Evropian
ZEE	Zona Ekonomike Evropiane
NJKIBE	Njësia për Koordinim të Integritetit në BE
PE	Parlamenti Evropian
KK	Kontratë Kornizë
GIZ	Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
MBNj	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IPA	Instrumenti i Ndhmës Para Anëtarësimit
UNP	Unioni Ndërparlamentar
MIE	Ministria e Integriteteve Evropiane
DK	Deputet i Kuvendit
MAP	Ministria e Administratës Publike
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
NDI - IKD	Instituti Kombëtar i Demokracisë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RTM	Raport Tremujor
MOR	Monitorim i Orientuar në Rezultat
RReP	Rregullorja e Punës
KTR	Këshilltari Vendor i Binjakëzimit
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit
KPSA	Komisioni Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim
KD	Komiteti Drejtues
SMART	Specifike, të Matshme, të Arritshme, Relevante dhe Të kufizuara në kohë
EASH	Ekspert Afatshkurtër
VNT	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
TeR	Termet e Referencës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
GKBV	Grupi i Kombeve të Bashkuara për Vlerësim
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Përmbledhje ekzekutive

Zyra e BE-së në Kosovë ka organizuar një vlerësim të pavarur të tri projekteve të binjakëzimit me Kuvendin e Kosovës. Projektet u zhvilluan ndërmjet 2011 dhe 2018, për një vlerë totale prej 3.05 milion Euro: Projekti i parë i Binjakëzimit "Mbështetje për Kuvendin e Kosovës", projekti i dytë i Binjakëzimit "Forcimi i funksionimit të Kuvendit të Kosovës" dhe projekti i tretë i binjakëzimit "Mbështetje e mëtejme për Kuvendin e Kosovës". Vlerësimi u zhvillua në tetor 2018 nga Franklin De Vrieze në emër të Konsorciumit të udhëhequr nga Particip duke përfshirë EuroPlus Consulting & Management.

Vlerësimi mbi realizimin e programit

Duke analizuar hartimin e projektit, ne kemi shqyrtuar se deri në çfarë mase ka pasur bazë solide për zbatimin e suksesshëm të projektit. Ndërlidhja e projekteve të binjakëzimit ekziston pa ndonjë dyshim, pasi ato lidhen me strategjinë e KE-së për Kosovën dhe MSA-në ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Objektivat e tri projekteve të binjakëzimit lidhen posaçërisht me përafrimin e BE-së dhe zbatimin e praktikave më të mira të BE-së. Projektet synojnë të përmirësojnë kapacitetet legjislative, mbikëqyrëse dhe administrative të Kuvendit, si dhe njohuritë dhe aftësitë lidhur me përafrimin e BE-së dhe një rol më të madh për Komisionin për Integrimin Evropian. Rëndësia që Kuvendi i jep projektit, lidhet qartë me perspektivën evropiane të Kosovës. Hartimi i projektit u bazua në një renditje të qartë të tri projekteve, një projekt i ndërtuar mbi rezultatet e projektit të mëparshëm. Projektet janë përgatitur si një projekt i përbashkët i përfituesit (Kuvendi i Kosovës) dhe partnerit zbatues (Parlamenti i Hungarisë).

Duke analizuar zbatimin e projektit, ne pranojmë se Projektet e Binjakëzimit kanë dhënë vlerësime cilësore dhe solide të mjedisit aktual ligjor dhe institucional në secilën nga temat e programit, siç është dokumentuar në Librat e Binjakëzimit dhe raportet e aktiviteteve. Rezultatet praktike të projekteve për ndërtimin e kapaciteteve përfshinin një vlerësim të nevojave për trajnim, punëtori trajnimi, trajnime në vendin e punës, vizita studimore jashtë vendit, praktika, tryeza të rumbullakëta publike, manuale, raporte të përgjithshme dhe dokumente hulumtuese parlamentare të cilat janë rishikuar. Nga këndvështrimi i vlerësimit, cilësia e këtyre rezultateve është mjaft e kënaqshme.

Udhëheqja e Sekretariatit të Kuvendit bën një dallim të qartë në vlerësimin e saj për rezultatet e projektit të parë, të dytë dhe të tretë. Projekti i parë kishte rezultate të qarta, ndërsa rekomandimet e projektit të dytë u konsideruan të një cilësie të mirë edhe pse ato nuk mund të zbatoheshin për arsye politike. Megjithatë, rezultatet e projektit të tretë janë parë me rezerva nga udhëheqja e Sekretariatit të Kuvendit, kryesisht në lidhje me rezultatin përfundimtar të projektit të tretë, Planin e Veprimit dhe rekomandimet e tij.

Qasja kryesore metodologjike e projekteve të binjakëzimit është të zhvillojnë aktivitete që kontribuojnë në krijimin e rekomandimeve thelbësore mbi reformat procedurale dhe strukturore në Kuvend, të identifikuar si rezultate të pajtuara në një proces të përbashkët të zbatimit të projektit.¹

¹ Koncepti i "rezultateve të detyrueshme" është tipar kyç i Binjakëzimit. Të dy partnerët e projektit zotohen të punojnë drejt rezultateve të pajtuara në një proces të përbashkët të zbatimit të projektit. Komisioni ka theksuar që në fillim se projektet e binjakëzimit duhet të fokusohen në objektiva institucionale të kufizuara dhe të përcaktuara mirë. Këto 'rezultate të detyrueshme' mund të jenë një pikë referimi e ndërmjetme, e cila përbën një kriter të veçantë në lidhje me kapacitetin administrativ, përderisa ekziston një objektivi i përbashkët. Objektivi duhet të jetë i matshëm dhe preciz. Në përfundimin e një projekti të Binjakëzimit, BC duhet të ketë një organizim të përmirësuar dukshëm që të mundësojë pëmbushjen e objektivave të veta në lidhje me acquis-in e BE-së ose në lidhje me fushën përkatëse të bashkëpunimit me BE-në. Prandaj qëllimi i binjakëzimit është të prodhojë një rezultat operacional në një fushë të caktuar. Arritja e këtij qëllimi kërkon një bashkëpunim të gjatë dhe të plotë midis BC dhe MS, duke sjellë në punë çfarëdo veprimi që kërkohet për të arritur rezultatet e dëshiruara. Në rast se kjo nuk arrihet, pas binjakëzimit të tretë, atëherë instrumenti i binjakëzimit është shumë i avancuar për administratën përfituese, pasi ajo nuk ka kapacitete për ta ndjekur atë.

Rekomandimet rrjedhin nga vlerësimet fillestare, praktikat më të mira në parlamentet e tjera në Evropë dhe punëtoritë me stafin parlamentar (dhe në një masë të kufizuar edhe deputetët) për të diskutuar vlerësimin bazë, praktikat më të mira dhe draft rekomandimet.

Bazuar në intervistat tona me stafin e lartë të Sekretariatit të Kuvendit, duket se qasja e hartimit dhe shpërndarjes së rekomandimeve nuk është nxitje e mjaftueshme për ndryshim. Menaxhimi i ndryshimeve kërkon më shumë se njohuri se çfarë duhet të ndryshojë, por gjithashtu ka nevojë për një trajktore të këshillimit, ushtrimit dhe avokimit për të zbatuar ndryshimet e propozuara. Modeli dominues i Projekteve të Binjakëzimit, duke gjeneruar rekomandime drejt përfundimit të afatit kohor të projektit dhe duke pritur që institucioni përfitues t'i çojë ato përpara, duket të ketë pasur sukses të kufizuar. Trajnimi i nevojshëm i këshillimit, përgatitjes dhe avokimit (në veçanti drejt nivelit politik në Kuvend) për të zbatuar ndryshimet e propozuara ka mbetur jashtë afatit kohor të projekteve të Binjakëzimit, të cilat u bënë më të dukshme pas projektit të dytë dhe të tretë.

Rezultati përfundimtar i tri projekteve të binjakëzimit është "Plani i Veprimit për të përmirësuar aktivitetet e Kuvendit për një proces të suksesshëm të integritit në BE". Dokumenti përbëhet nga 224 rekomandime, 178 veprime për nivelin politik dhe 46 veprime për nivelin administrativ të Kuvendit.

Intervistat me përfaqësuesit e lartë të Sekretariatit të Kuvendit zbuluan rezerva serioze për numrin e rekomandimeve. Pas marrjes së ndihmës nga tri projekte të binjakëzimit, numri i 224 rekomandimeve i befasoi udhëheqësinë e Sekretariatit të Kuvendit, pasi u perceptua si një vlerësim negativ i funksionimit dhe kapacitetit të Sekretariatit të Kuvendit dhe kontribuoi në një marrëdhënie të tensionuar midis partnerit implementues dhe udhëheqjes së Sekretariatit të Kuvendit.

Në përmbajtjen e Planit të Veprimit, shumica e rekomandimeve janë të forta dhe relevante për t'u zbatuar me synimin për të arritur një rol më të fortë të Kuvendit në procesin e integritit evropian. Përmbajtja e Planit të Veprimit rrjedh nga puna e bërë në tri projekte dhe konsultimet me udhëheqësit e komponentit. Një numër i kufizuar i rekomandimeve nuk janë mjaft të veçanta, politikisht jo të rregulluara mirë në kontekstin e Kosovës, ose ato i referohen ruajtjes së disiplinës në zbatimin e rregullave dhe praktikave ekzistuese.

Pas shqyrtimit, formati i Planit të Veprimit ndoshta mund të ndërtohet ndryshe, si grupimi i rekomandimeve në një sasi më të vogël rekomandimesh kryesore (me nën-rekomandime), vendosja e një prioritizimi të detyrave (aktualisht nuk ka prioritet apo renditje), afatet paraprake (aktualisht nuk ka afate përtej 189 herë "menjëherë" dhe 25 herë "deri në fund të mandatit të tanishëm ligjor 2021") dhe duke vënë në dukje pasojat buxhetore (aktualisht nuk ka shuma të përmendura). Formatit i tabelës së Planit të Veprimit nënkuptonte që referencat ishin bërë në raporte të ndryshme të aktiviteteve dhe në seksione të raporteve të tjera të projektit të Binjakëzimit. Si rezultat, Plani i Veprimit vështirë se mund të lexohet si dokument i pavarur sepse mbështetet në informacionet në dokumentet e tjera të projektit (të cilat janë referuar në një kolonë të veçantë). Prandaj, si dokumenti përfundimtar i projekteve të binjakëzimit, nuk është i përshtatshëm për lexuesit, as gjithëpërfshirës për të mundësuar që lexuesi të kuptojë plotësisht se çfarë nënkuptohet për secilën pikë, pa pasur nevojë të lexojë shumë dokumente mbështetëse.

Duke analizuar menaxhimin e projektit, u vu re se projektet e Binjakëzimit janë monitoruar rregullisht nga brenda. Janë mbajtur takime të rregullta në mes të Këshilltarit të Binjakëzimit vendor dhe udhëheqësve të Komponentëve të Sekretariatit të Kuvendit për të diskutuar progresin e bërë dhe veprimet për periudhën e ardhshme. Takimet e Komitetit Drejtues janë organizuar në baza tremujore, duke ofruar një platformë të hapur për diskutimin dhe zgjidhjen e çështjeve në pritje.

Ekspertët afatshkurtër (EASH) kanë luajtur rol kyç në projekt. Gjatë projektit të parë të binjakëzimit kanë qenë të angazhuar EASH-të nga tetë vende. Gjatë projektit të dytë ka pasur numër të kufizuar të EASH-ve. Gjatë projektit të tretë, parlamenti hungarez solli 58 EASH nga 11 parlamentet

kombëtare, si dhe një numër shtesë të zyrtarëve të lartë, komisionerëve ministrorë dhe ish-deputetëve. Shumica e EASH-ve realizuan punë të cilësisë së mirë. Disa EASH kishin punuar në Kosovë për disa vite dhe kishin krijuar marrëdhënie të mira personale me homologët e tyre në Kuvend. Intervistat me stafin e lartë të Kuvendit treguan se një numër i kufizuar i EASH-ve bënë përpjekje të kuptojnë plotësisht funksionimin e Kuvendit, sistemin e tij ligjor dhe realitetet politike në Kosovë.

Ndërkohë që projektet e binjakëzimit kryesisht ndërveprojnë me administratën e Kuvendit, ndërveprimi me nivelin politik mund të kishte qenë më i fortë dhe se kryesisht ishte përqendruar tek kryetarët e zgjedhur të Komisionit dhe një numër i kufizuar takimesh me nënkryetarin dhe kryetarin.

Si një nga projektet më të mëdha të asistencës në Kuvend, projektet e binjakëzimit kishin kontakte të rregullta me projektet e tjera të donatorëve që punonin në Kuvend, si UNDP, NDI, GIZ, OSBE dhe të tjerë. Si pjesë e vlerësimit, ne kemi vërejtur se projektet zakonisht e informojnë njëra-tjetrën për aktivitetet e kaluara ose të ardhshme. Kishte përpjekje për ndarjen e punës midis projekteve të donatorëve me synim shmangien e mbivendosjes së panevojshme dhe dyfishimit; ndonëse bashkëpunimi i donatorëve me anë të rekomandimeve të përbashkëta ose aktiviteteve të përbashkëta nuk ka ndodhur.

Siç ka ardhur në përfundim vlerësuesi, projekti i binjakëzimit mund të ketë bashkëpunim të zgjeruar me partnerë të tjerë dhe mundësi më të mëdha për zbatimin e rekomandimeve të tij nëse do të kishte ndarë për konsultim draft vlerësimet e tij dhe projekt rekomandimet dhe nëse do të kërkonte blerje, kontribut dhe miratim nga projekte të tjera për rekomandime të synuara. Megjithatë Kuvendi është përfituesi i projektit dhe pronari i versionit përfundimtar të dokumenteve, ne kemi mësuar nga Zyra e BE-së në Kosovë se nuk ka pengesë për projektin e Binjakëzimit për të ndarë draft versionet e dokumenteve për konsultim me projekte të tjera të donatorëve. Vërehet se projekti ka ndarë versionin përfundimtar dhe të përcaktuar të dokumenteve.

Udhëheqësi i ekipit të projektit të Binjakëzimit dhe KTR-ja janë të mendimit se Kuvendi duhet të marrë një rol më të fuqishëm në koordinimin e donatorëve dhe të sigurojë që asistencë e njëjtë nuk kërkohet nga më shumë se një projekt i donatorëve. Realiteti është se projektet e ndryshme të asistencës implementojnë atë që selia e tyre e donatorëve i ka porositur të bëjnë. Mënyra e arsyeshme më tej është që agjencitë kryesore të donatorëve - BE, USAID dhe Ambasadat - të diskutojnë planifikimin e tyre afatgjatë dhe shpërndarjen e fondeve përpara fillimit të projekteve, kështu që ka më pak shanse që projektet zbatuese të mbesin dhe përpiqen të kapërcejnë dyfishimin mes tyre. Kjo qasje e sugjeruar është plotësuese e parimit kryesor të projekteve IPA që përfituesi duhet të tregojë llojin e mbështetjes që dëshiron të marrë nga Zyra e BE-së, pas së cilës mund të kërkohet një propozim i detajuar i mëtejshëm.

Zyra e BE-së në Kosovë ka ndjekur vazhdimisht zbatimin e të tri projekteve. Do të ishte e dobishme një analizë më e plotë dhe e shpeshtë nga Zyra e BE-së për ndikimin politik të disa prej rekomandimeve (për shembull, për të drejtat e votimit në komisione, përbërjen e komisioneve hetimore ose të drejtat e të folurit në seancë plenare). Kontrolli i cilësisë së Planit të Veprimit, si produkti përfundimtar i tri projekteve të Binjakëzimit, do të ishte i dobishëm.

Vlerësimi teknik i temave të programit

Projektet e binjakëzimit kanë ofruar asistencë teknike në shumicën e fushave kryesore të funksionimit parlamentar. Në vijim është dhënë një përmbledhje e shkurtër.

- 1 Fusha qendrore e tri projekteve të binjakëzimit është propozimi për ta bërë Kuvendin **institucion me funksionim plotësisht të pavarur**. Bazuar në rekomandimet e EASH-ve gjatë projektit të parë të Binjakëzimit dhe në marrëveshje të plotë me Kuvendin e Kosovës dhe Zyrën e BE-së në Kosovë, projekti i Binjakëzimit Light është hartua lidhur me përgatitjen e një projektligji për

Kuvendin, me rregulloret përkatëse. Zbatimi i tij i plotë do të ndiqej gjatë tërë fazës së tretë të projektit të Binjakëzimit. Kur filloi projekti i tretë i binjakëzimit, ai u gjet në një kontekst pak më të ndryshëm. Ligji për Kuvendin kishte hasur në rrethana të rënda politike, dhe u bë e qartë se miratimi i projektligjit ishte vënë në pritje të realizimit të Reformës së Administratës Publike, siç shprehet gjatë takimeve me udhëheqjen e Sekretariatit të Kuvendit.

Nga pikëpamja e vlerësimit, është e qartë se projektligji për Kuvendin kishte për qëllim ndryshime thelbësore në funksionimin e kuvendit dhe marrëdhëniet e tij me autoritetet e tjera publike, në veçanti me qeverinë. Projektligji që përshkruan këto ndryshime thelbësore u hartua brenda kornizës shumë të ngushtë të projektit të Binjakëzimit Light - vetëm gjashtë muaj - dhe më pas nuk kishte kohë të mjaftueshme për t'u angazhuar me të gjithë aktorët me qëllim të shpjegimit të qëllimit dhe përfitimeve të projektligjit, veçanërisht duke marrë parasysh se gjatë kohës së zbatimit të Binjakëzimit Light, u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme dhe u paraqitën vështirësi të tjera politike.

Për një propozim sa më gjithëpërfshirës si ligji për Kuvendin, ishte shumë e rëndësishme të parashikohej në një proces konsultimi, kontributi dhe krijimi i mbështetjes politike me udhëheqësit e partive politike, me udhëheqjen e kuvendit dhe qeverisë, projektet e tjera të donatorëve në kuvend dhe organizatat dhe diplomatët ndërkombëtarë, si dhe seksionin politik të Zyrës së BE-së. Hartimi i një projektligji të tillë tejte të rëndësishëm dhe rregulloreve shoqëruese, pa konsultime të gjera dhe përfshirje të bazuar në përmbytje të aktorëve të përmendur, është dëshmuar të jetë një qasje jo e plotë e cila ka qenë viktimitë e rrezikut që projekti të ngecte sapo të bëheshin pyetje ose të bëheshin përpjekje për të ndryshuar drejtimin e projektit nëpërmjet amendamenteve lidhur me pagat e deputetëve..

- 2 Me qëllim të përmirësimit të **procesit legjislativ** në kuvend, projektet e Binjakëzimit sugjeruan modifikime në Rregulloren e Punës së Kuvendit (RReP). Projekti ka pohuar që Kuvendit duhet ofruar legjislacion më cilësor dhe më mirë i përpiluar si dhe më i bazuara për shqyrtimin e projektligjeve. Projekti rekomandoi që kuvendi të refuzojë projektligjet që nuk kanë memorandum shpjegues gjithëpërfshirës. Projekti po ashtu ka identifikuar që deklarata e qeverisë për harmonizim me Acquis-in shpesh është e paqartë, duke pohuar se projektligji është plotësisht ose pjesërisht i harmonizuar me Acquis pa ofruar shumë shpjegime apo justifikime. Projekti ka vërejtur që tabela e pajtueshmërisë është shpesh jo e plotë, mungon informacioni se në çfarë niveli ka arritur përafrimi i ligjit, arsyet për të dhe afatet përkatëse. Përveç kësaj, tabela e pajtueshmërisë nuk ofrohet në gjuhën shqipe dhe serbe, por vetëm në anglisht, dhe kështu nuk mund të konsiderohet si dokument zyrtar. Për të forcuar kapacitetin e administratës së Kuvendit për të ofruar mbështetje cilësore për procesin legjislativ, projekti ka sugjeruar që Drejtoria për Standardizimin, Përafrimin dhe Harmonizimin Ligjor të ristrukturohej dhe të ndahej në dy njësi: një njësi përgjegjëse për çështjet e përgjithshme ligjore dhe kodifikimin, dhe njësi e dytë përgjegjëse ekskluzivisht për përafrimin ligjor me acquis-in e BE-së. Projekti i Binjakëzimit ka përgatitur një draft rregullore për riorganizimin e propozuar. Projekti gjithashtu ndau praktikën evropiane mbi çështjen e nevojës për konsolidimin e legjislacionit dhe mbështeti idenë që sistemi i përcjelljes legjislative të përdoret plotësisht. Projekti i tretë i binjakëzimit ka përgatitur një Doracak për analizën ligjore dhe një Doracak për përafrimin ligjor evropian.

Një numër i konsiderueshëm i reformave të propozuara nga projekti i binjakëzimit varen nga mundësia e Kuvendit për të u pajtuar për ndryshimet në RReP. Miratimi i ndryshimeve në RReP kërkon një shumicë prej 2/3 të deputetëve, ku kërkohej votat e 80 prej 120 deputetëve. Kuptohet që Komisioni për Legjislacion ka miratuar projekt-ndryshimet në RReP, megjithatë ky vendim është marrë me shumicë votash e jo me konsensus siç do të ishte e dëshirueshme për një dokument aq të rëndësishëm sa RReP. Për të mbështetur funksionimin e përmirësuar të Kuvendit, tani dhe në mandatin e ardhshëm, mund të themi se - në parim - ndryshimet në RReP

meritojnë pajtimin e përbashkët të partive qeverisëse dhe të opozitës. Në këtë raport kemi identifikuar gjashtë fusha me prioritet për sqarime në RReP-në e rishikuar; dhe ne sugjerojmë që Kuvendi të shqyrtojë gjashtë fushat me prioritet të lartpërmendura për sqarime dhe të bëjë verifikimin e gjuhës/përkthimit të dokumentit, para se të votohet përfundimisht për RReP-në e re. Shpresojmë që shqyrtimi i gjashtë fushave me prioritet do të ndihmojë në lehtësimin e një miratimi të orientuar në konsensus për RReP-në e re.

- 3** Për të forcuar **praktikat e menaxhimit në Kuvend**, projekti i Binjakëzimit ka bërë rekomandime lidhur me menaxhimin financiar dhe buxhetor, burimet njerëzore dhe për sistemin e TIK-ut. Në fushën e menaxhimit financiar dhe buxhetor, projekti i parë i binjakëzimit bëri një vlerësim të mirë dhe paraqiti propozime solide për përmirësimin e menaxhimit të buxhetit të Kuvendit. Si rezultat, praktikat e raportimit të buxhetit gjatë gjashtë viteve të fundit janë përmirësuar. Gjatë projektit të dytë të binjakëzimit, u përgatit një rregullore për menaxhimin e buxhetit dhe decentralizimin. Gjatë projektit të tretë, trajnimet dhe konsultimet u përqendruan në decentralizimin e buxhetit si një instrument i menaxhimit të mirë publik që do të rriste efikasitetin përmes delegimit të përgjegjësisë në menaxhimin e Kuvendit.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (MBNj) ka qenë prioritet për të tri projektet e Binjakëzimit. Gjatë projektit të parë dhe të dytë janë përgatitur vlerësime dhe rregullore që synojnë forcimin e autonomisë së Kuvendit në MBNj, duke përfshirë klasifikimin e pozitave dhe proceseve të rekrutimit. Projekti i parë i binjakëzimit sugjeroi që të krijohet një lidhje e qartë mes strategjisë organizative dhe përgjegjësisë dhe detyrave të punonjësve individualë. Gjatë gjithë punës së vlerësimit, shumica e stafit të lartë të Kuvendit shprehën rregullisht qëndrimin se Ministria e Administratës Publike nuk respekton autonominë e Kuvendit nëpërmjet vendimeve të veta për zgjedhjen apo mos zgjedhjen e pozitave të propozuara të punës. Ekspertët e binjakëzimit zhvilluan një vlerësim të nevojave për trajnim (VNT) të të gjithë stafit të Sekretariatit, i cili është bazë për strategjinë e trajnimit të Kuvendit. Duket se nevojitet më shumë punë për të siguruar që rezultatet e trajnimeve të lidhen me prioritetet e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe vlerësimin e performancës së stafit në Kuvend.

Projekti i parë i binjakëzimit mbështeti autonominë e TIK-ut të Kuvendit dhe zbatimin e një projekti e-parlamenti ka filluar. Projekti ka avokuar për krijimin e një sistemi të brendshëm të informimit (intranet) i cili mund të përdoret nga deputetët, komisionet dhe stafi i Kuvendit për të mbështetur legjislacionin dhe për të shkëmbyer informacione dhe të dhëna të tjera. Bazuar në këto rekomandime, është elaboruar një plan veprimi për zhvillimin e TIK-ut të Kuvendit në kuadër të Projektit të Binjakëzimit Light. Gjatë projektit të tretë të binjakëzimit është hartuar një rregullore për transmetimin dhe përdorimin e videos dhe incizimin e seancës plenare; dhe po pritet miratimi nga Kryesia e Kuvendit.

- 4** Një pjesë e konsiderueshme e punës së Projektit të Binjakëzimit u fokusua në forcimin e **funksionit mbikëqyrës të Kuvendit** në nivel të seancave plenare dhe komisioneve. Janë formuluar rekomandime se si të kryhet mbikëqyrja efikase mbi të gjitha aktivitetet e Qeverisë, duke përfshirë pyetjet me gojë dhe me shkrim, interpelancat dhe debatet plenare në fushat më të gjera të politikave. Nga pikëpamja e vlerësimit, miratimi i këtyre rekomandimeve kërkon angazhim substancial nga niveli politik i Kuvendit dhe qeveria. Është e paqartë se deri në çfarë mase projekti i Binjakëzimit ka arritur të krijojë interes dhe gatishmëri politike drejt zbatimit të rekomandimeve për mbikëqyrjen e qeverisë. Projekti i Binjakëzimit ka bërë propozime për mbikëqyrjen e Kuvendit mbi agjencitë e pavarura. Si pjesë e reformës së vazhdueshme të administratës publike, në tri vitet e ardhshme do të zbatohet një rishikim funksional dhe racionalizimi i institucioneve të pavarura me rolin udhëheqës të Ministrisë së Administratës Publike dhe me përfshirjen e Kuvendit. Projekti i binjakëzimit ka formuluar rekomandime se si Kuvendi mund të mbikëqyrë më mirë institucionet dhe agjencitë e pavarura kryesisht përmes

procedurës së emërimit dhe nominimit dhe vlerësimin të raporteve të tyre vjetore. Këto rekomandime janë solide dhe të vlefshme, megjithëse projekti mund të ketë ofruar një propozim më të hollësishëm dhe afat kohor se si t'i zbatojnë ato dhe kush duhet të bëjë çfarë dhe si.

- 5** Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së përcakton në disa aspekte përgatitjen për **integrimin në BE**, duke përfshirë edhe për Kuvendin. Për shkak se detyrat që rrjedhin nga MSA-ja kanë një natyrë horizontale, jo vetëm Komisioni për Integrimin Evropian (KIE) ka rol në këtë proces, por përfshirja dhe angazhimi i të gjitha komisioneve ka një rëndësi të veçantë. Bazuar në analizën, trajnimet, punëtoritë dhe aktivitetet e këshillimit në vendin e punës të ofruara gjatë projektit të parë dhe të dytë të Binjakëzimit, projekti i tretë i binjakëzimit ka zhvilluar disa rekomandime për katër fusha specifike: (1.) rolin dhe funksionimin e KIE; (2.) funksionimin e Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit të BE-së (KPSA); (3.) forcimin e përfshirjes së komisioneve të tjera të Kuvendit në procesin e MSA-së; (4.) përmirësimin e rolit të Kuvendit në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme për çështjet e BE-së.
- 6** **Mbështetja administrative për deputetët lidhur me detyrat në procesin e integritit evropian** ka qenë një tjetër fushë tematike të projektit të binjakëzimit. Rekomandimet e projektit të binjakëzimit mbulojnë tri fusha kryesore: rekomandime për të zhvilluar strukturat administrative përgjegjëse për detyrat e integritit në BE; rekomandimet për strategjinë për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe bashkëpunimin ndërligjësor lidhur me MSA-në; dhe rekomandimet për përmirësimin dhe avancimin e aktiviteteve kërkimore.

Konkluzionet e vlerësimit përfshijnë gjetjet në lidhje me rëndësinë, efikasitetin, efektivitetin, ndikimin, qëndrueshmërinë, vlerën e shtuar nga BE dhe koherencën e tri projekteve të binjakëzimit.

Bazuar në gjetjet e këtij vlerësimi të tri projekteve të njëpasnjëshme të binjakëzimit, perceptimet e përfituesve dhe reagimet nga institucioni zbatues i binjakëzimit, raporti arrin në përfundimin se modaliteti i projekteve të binjakëzimit është shfrytëzuar sa i përket Kuvendit të Kosovës.² Procesi i kryerjes së vlerësimeve dhe hartimit të rekomandimeve për përfituesin është përfunduar. Tani ekziston nevoja për një modalitet ku asistencë teknike shkon së bashku me një proces të shoqërimit të reformave dhe zhvillimin e njohurive dhe aftësive në një mënyrë më interaktive.

Rekomandimet pas këtij vlerësimi përfshijnë, së pari, se është e rëndësishme që Zyra e BE-së në Kosovë të vazhdojë të mbështesë Kuvendin e Kosovës përmes një projekti të ri. Megjithatë, është e justifikueshme të vihet në dukje nevoja për përparim në reformat e propozuara të sugjeruara nga tri projektet e fundit të financuara nga BE-ja. Prandaj, ne rekomandojmë zbatimin e një liste të shkurtër të reformave me prioritet në Kuvend në dy deri në tre muajt e ardhshëm, përpara ndihmës së mëtejshme të BE-së për Kuvendin.

Shtrirja tematike e rekomanduar e projektit të ri të BE-së me Kuvendin e Kosovës do të ishte e trefishtë: Në integrimin evropian, mbikëqyrjen parlamentare dhe profesionalizimin e administratës. Sugjerohet që projekti i ri, i nisur nën modalitetin e Asistencës Teknike (i paraparë si modalitet i granteve), do të përqendrohet në Administratën e Kuvendit për 75% dhe në nivelin politik për 25%, me mundësi për të ndryshuar përqindjen në rast të zgjedhjeve të parakohshme dhe/ose vonesës në

² Aktivitetet e binjakëzimit janë ideale për projektet me tiparet e mëposhtme: qëllimi është relativisht i qartë, pra KP të kuptojë mirë pjesën relevante të acquis-it ose fushës përkatëse të bashkëpunimit dhe ka zgjedhur llojin e sistemit që synon të miratojë; ekziston vullneti i mjaftueshëm politik në KP për të krijuar kushtet më të mira të mundshme për hartimin dhe miratimin e legjislacionit përkatës; ekziston një angazhim i mjaftueshëm i KP-së për të siguruar që burimet e nevojshme (financiare, personeli) të mobilizohen në një projekt binjakëzimi; prioritet të përcaktuar mirë në agjendën e vet të administratës përfituese, duke garantuar që ideja e Binjakëzimit të rrjedhë nga nevoja aktuale. Vlerësimi i ROM-it pas projektit të parë të binjakëzimit nxori një vlerësim pozitiv të qartësisë së qëllimit, vullnetit politik, zotimit të përfituesit dhe prioritetëve në agjendën e përfituesit.

formimin e Kuvendit të ri dhe qeverisë. Ne rekomandojmë një afat kohor prej tri deri në katër vite dhe metodologjitë që përfshijnë ndërtimin e njohurive, ndërtimin e aftësive, trajnimin në punë, mësimin interaktiv, asistencën teknike, dërgimin e stafit në një parlament tjetër, mësimin nga kolegët dhe shkëmbimet rajonale.

1 Hyrje

Që nga viti 2006 Bashkimi Evropian (BE) ka ofruar mbështetje të konsiderueshme për Kuvendin e Kosovës. Zyra e BE-së në Kosovë ka organizuar një vlerësim të tri projekteve të binjakëzimit të nisura në periudhën pas shpalljes së pavarësisë.

Si pjesë e KK financuar nga BE, Konsorciumit të udhëhequr nga Particip duke përfshirë Europlus Consulting & Management i është dhënë kontrata për të kryer një vlerësim i mbështetjes së financuar nga BE ofruar Kuvendit të Kosovës. Franklin De Vrieze është eksperti kryesor për këtë detyrë vlerësimi. Misioni i vlerësimit në Prishtinë është kryer ndërmjet 1 e 16 tetor 2018.

Kapitulli i hyrjes së raportit të vlerësimit përshkruan shkurtimisht funksionimin aktual të Kuvendit të Kosovës, pasuar nga një përshkrim i shkurtër i projekteve dhe objektivave dhe metodologjisë së vlerësimit.

1.1 Kuvendi i Kosovës

Institucionet demokratike të Kosovës janë të konsoliduara por të reja dhe përballen me sfida të konsiderueshme. Drejtuesi kryesor i reformës demokratike është procesi i integritimit në Bashkimin Evropian³, megjithatë ritmi aktual i realizimit të reformave është i ngadalshëm, siç është theksuar në raportin e progresit të KE-së për Kosovën në vitin 2018.⁴

Demokratizimi është një nga gurët e themelit të përpjekjeve ndërkombëtare në Kosovë, megjithatë, në shumë raste, prioriteti i është dhënë sigurisë dhe stabilitetit. Kjo ka çuar deri te një skenë politike e cila është mjaft e polarizuar midis partive me profil të kufizuar ideologjik, me ngecje të shpeshta dhe nevojën për të thelluar kulturën demokratike. Besimi publik në institucionet politike është rritur pak, sipas një sondazhi publik të perceptimit publik të kryer nga UNDP-ja, megjithatë kënaqësia e përgjithshme për drejtimin politik mbetet e ulët.⁵

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë mbajtur në qershor të vitit 2017. U pasuan me muaj të negociatave të zgjata për të themeluar një koalicion të ri dhe për të formuar qeverinë.

Sikurse të gjitha institucionet, Kuvendi i Kosovës është organ relativisht i ri, aktualisht në thirrjen e tij të gjashtë; pasqyron gjerësisht hapësirën politike tejet të polarizuar. Thirrje të shumta të parlamentit nuk kanë përfunduar mandatin e tyre të plotë; puna e Kuvendit është bërë shpesh arenë e diskursit jo-parlamentar, bojkoteve dhe incidenteve siç është përdorimi i gazit lotsjellës.

Siç është theksuar në TeR për këtë detyrë, Kuvendi duhet të përmirësojë konsiderueshëm performancën e tij si forum për dialog konstruktiv politik dhe përfaqësim, si dhe të garantojë kontrolle dhe balance të duhura. TeR përmend se si partitë e koalicionit qeverisës ashtu edhe ato të opozitës duhet të intensifikojnë punën e tyre parlamentare dhe të kërkojnë konsensus për reformat me prioritet që lidhen me BE-në. Në përgjithësi, mbikëqyrja efektive nga Kuvendi ndaj ekzekutivit si dhe cilësia e ligj-bërjes duhet të përmirësohen.

Kuvendi nuk takohet rregullisht, legjislacioni grumbullohet dhe pastaj e kalon të njëjtin në mënyrë të nxituar. Përveç kësaj, i mungon efikasiteti në mbajtjen e qeverisë përgjegjëse dhe monitorimin e efektivitetit të ligjeve. As Siç është përmendur në TeR, emërimet e organeve të pavarura të bëra nga Kuvendi vazhdojnë të jenë të ndikuara politikisht, analiza e buxhetit dhe funksionet e kontrollit duhet

³ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417_strategy_paper_en.pdf

⁴ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

⁵ http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xiii.html

të fuqizohen, dhe duhet themeluar dhe monitoruar mënyrat për të siguruar se rekomandimet e komisioneve zbatohen.

Megjithatë mbikëqyrja efektive ndaj qeverisë nuk varet vetëm nga Kuvendi. Qeveria duhet përmbajtur parimeve demokratike të kontrollit efektiv nga parlamentit. TeR po ashtu me të drejt theksojnë se vëmendja ministrove ndaj legjislacionit në Kuvend, duke filluar nga propozimet deri te miratimi, duhet të përmirësohet. Mos vijimi i ministrave në seancat plenare dhe mos përgjigja ndaj pyetjeve parlamentare vazhdojnë të dëmtojnë transparencën, llogaridhënien dhe komunikimin me Kuvendin. Shpeshësia me të cilën qeveria avokon procedurat e miratimit të përsheptuar të legjislacionit (22 nga 115 ligje janë miratuar në këtë mënyrë, siç theksohet në TeR) nënkupton se një pjesë mjaft e madhe e legjislacionit miratohet pa debat substancial apo konsultim me akterët përkatës.

Kuvendi ka shënuar ca përparim në përmirësimin e transparencës së punës së tij, duke përfshirë aktivizimin e sistemit elektronik të përcjelljes, ofrimin e qasjes për publikun në të gjitha informacionet dhe dokumentet në projektligjet nën shqyrtim. Administrata e Kuvendit funksionon nën udhëheqjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Sekretariati i Kuvendit përbëhet nga dy Drejtori të Përgjithshme: Drejtorja e Përgjithshme për Çështjet Ligjore dhe Procedurale dhe Drejtorja e Përgjithshme e Administratës, ku secila ka disa drejtori nën to. Zyra e SP-së ka këto njësi organizative: Drejtorja për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun dhe Drejtorja e Prokurimit. Në mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Sekretarit të Përgjithshëm janë Auditori i Brendshëm dhe Zyrtari Certifikues për Financa. Administrata e Kuvendit ka qenë përfituesi kryesor direkt i projekteve të binjakëzimit.

1.2 Përshkrim i veprimit

1.2.1 Objektivat dhe rezultatet e tri projekteve

Siç është përmendur në dokumentacionin e projektit, të tri projektet kanë pasur objektiva dhe rezultate specifike:

- 1 Projekti i parë i binjakëzimit: "Mbështetje për Kuvendin e Kosovës", kishte objektivin e përgjithshëm që të mbështesë Kuvendin e Kosovës në përballjen me sfidat e integritetit në BE për parlamentin kombëtar. Për të arritur këtë, janë përpunuar rekomandime në kuadër të Projektit, për të zhvilluar kapacitetet administrative të Kuvendit, dhe në veçanti të Kryesisë dhe Komisioneve. Duke u fokusuar në praktikën më të mira të BE-së, janë bërë po ashtu propozime për të përmirësuar kompetencën teknike në lidhje me përafrimin me BE-në. Qëllimi i projektit ka qenë që të ndihmojë Kuvendin të u përgjigjet kërkesave të vëna në Partneritetin Evropian.
- 2 Projekti i dytë i binjakëzimit: Qëllimi i projektit ka qenë të shqyrtojë propozime për pjesë të ndryshme të legjislacionit dhe të fuqizojë kodifikimin e përgjithshëm dhe kapacitetin për krijimin e rregullave të administratës me qëllim të avancimit të funksionimit efikas të Kuvendit. Projekti ka përgatitur Projektligjin për Kuvendin, një Strategji për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe draft rregullat e brendshme të Administratës dhe ndryshimet në Rregulloren e Punës së Kuvendit.
- 3 Projekti i tretë i binjakëzimit "Mbështetja e mëtejshme për Kuvendin e Kosovës" kishte si objektiv të ndihmojë Kuvendin e Kosovës për të përmbushur standardet demokratike të funksionalitetit. Projekti ka synuar të mbështesë krijimin e kushteve të funksionimit të pavarur të Kuvendit, për të forcuar rolin e vet mbikëqyrës në lidhje me punën e Qeverisë dhe Agjencive të Pavarura; për të forcuar rolin e Kuvendit të Kosovës në çështjet që lidhen me BE-në, veçanërisht në procesin e MSA-së. Projekti ka përfunduar në mars 2018.

1.2.2 Përfituesit e synuar dhe akterët e tri projekteve

Përfituesit e drejtpërdrejtë të projekteve të përfshira në këtë vlerësim janë: Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit, të gjithë deputetët, veçanërisht ata që merren me çështjet e integritetit në BE dhe të tjerë në komisione të ndryshme të përhershme, Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi i shërbimit civil të Kuvendit sipas drejtorive të ndryshme.

Shoqëria civile, veçanërisht ata të angazhuar në monitorimin e performancës së Kuvendit, janë gjithashtu një palë e rëndësishme e interesit, si dhe të gjithë qytetarët e Kosovës. Disa programe donatore mbështesin Kuvendin për çështje të ndryshme, si NDI, GIZ, OSBE dhe UNDP.

1.2.3 Metodologjia e projekteve të binjakëzimit parlamentar

Të tri projektet u zbatuan bazuar në një metodologji të ngjashme: Së pari Ekipi i Binjakëzimit analizoi situatën aktuale, më pas ndërmoi një program trajnimit të përshtatur ose punëtori konsultative. Bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe trajnimit, janë përpunuar udhëzime dhe rekomandime për të futur struktura, procedura dhe metoda të reja ose të modifikuara për të krijuar dhe përforcuar standardet evropiane në punën e Kuvendit.

Udhëzimet dhe rekomandimet janë diskutuar me aktorët relevantë të Kuvendit në formën e tryezave të rrumbullakëta dhe intervistave. Në fund të çdo aktiviteti, një raport është shkruar nga ekspertët e binjakëzimit për të shpjeguar dhe përpiluar rezultatet e fazës së dhënë të procesit. Janë përpunuar pako të kompletuara të rekomandimeve ose udhëzime përfundimtare për përmirësim. Janë përpiluar doracakë dhe janë shpërndarë. Në fund të projektit të tretë, të gjitha rekomandimet u sintetizuan në një Plan Veprimi dhe u janë shpërndarë të gjithë deputetëve, stafit dhe palëve të tjera të interesit.

1.3 Objektivat e detyrës së vlerësimit

Objektivi i përgjithshëm i kësaj detyre është vlerësimi i tri projekteve të binjakëzimit me Kuvendin e Kosovës ndërmjet 2011 dhe 2018, për një vlerë të përgjithshme prej 3.05 milion euro:

- Mbështetja për Kuvendin e Kosovës, CRIS 2011/277-389
- Fuqizimi i funksionimit të Kuvendit të Kosovës, CRIS 2014/341-055
- Mbështetja e mëtejme për Kuvendin e Kosovës, CRIS 2016/372-105

TeR të detyrës janë të qarta për sa i përket përkufizimit të objektivave. Detyra është shumë e rëndësishme sa i përket projektimit të asistencës së ardhshme të KE-së. Formulimi i çdo ndihme të ardhshme për Kuvendin duhet të përmbledhë mësimet e nxjerra nga fazat e mëparshme të mbështetjes; dhe ky vlerësim do t'i mundësojë KE-së që të ndër marrë një shqyrtim të përgjithshëm të ndihmës së ofruar në periudhën pas pavarësisë deri më sot.

Qëllimi i përgjithshëm ishte vlerësimi i arritjeve, cilësisë dhe rezultateve të tri projekteve. Në mënyrë të veçantë, qëllimi ishte të kërkohen dëshmi se pse, nëse apo si këto rezultate janë të lidhura me ndërhyrjen e BE-së dhe të kërkohet identifikimi i faktorëve që shtyjnë ose pengojnë progresin.

Objektivat specifikë të këtij vlerësimi ishin të bëjnë një vlerësim të përgjithshëm të pavarur të performancës së tri projekteve dhe të identifikojnë mësimet dhe rekomandimet.

Më konkretisht, objektivat specifikë të vlerësimit ishin të kuptohet se deri në ç'masë programi ka kontribuar në funksionimin e Kuvendit si institucion i pavarur, me një rol më të fuqishëm mbikëqyrës dhe rol në çështjet e BE-së; për të kuptuar performancën e programit, faktorët e tij ndihmues dhe ata që pengojnë arritjen e duhur të rezultateve, dhe për të dhënë rekomandime për mbështetjen e mundshme të ardhshme për Kuvendin.

1.4 Metodologjia e vlerësimit

1.4.1 Hipotezat e vlerësimit

Metodologjia qendrore e projekteve të binjakëzimit është të punojë për të krijuar një sërë rekomandimesh mbi ndryshimet strukturore dhe procedurale në institucionin përfitues, identifikuar si rezultate të pajtuara bashkërisht në një proces të përbashkët të zbatimit të projektit. Hipoteza e parë për të shqyrtuar gjatë këtij vlerësimi ishte se deri në çfarë mase rekomandimet si të tilla ishin mjaftueshëm nxitëse për ndryshim dhe deri në çfarë mase rekomandimet ishin shoqëruar me një trajektore këshillimi dhe mësimi që do tu mundësonte komisioneve dhe administratës së institucionit që të rrisin performancën e tyre në mënyrë graduale.

Përvoja në projekte të tjera të forcimit parlamentar tregon se ka më shumë mundësi për ndryshime efektive kur propozimet për ndryshim, të zhvilluara në konsultim me përfituesit, gjithashtu shoqërohen gjatë zbatimit të tyre me një renditje të këshillimit dhe mundësive të përsëritura të të mësuarit. Hipoteza jonë e parë ishte se rekomandimet e mëhershme janë kristalizuar (për shembull kah mesi i kohës së zbatimit të projektit) dhe sa më shumë kohë të jetë në dispozicion për të shoqëruar zbatimin, aq më shumë ka mundësi për rezultate të qëndrueshme.

Hipoteza e dytë ka të bëjë me rëndësinë e praktikave më të mira evropiane në kontekstin evropian. Projektet e binjakëzimit kanë elaboruar propozime të bazuara në praktika në mbi 10 parlamentet kombëtare në Evropë dhe në Parlamentin e Evropës. Ndërsa mësimi rreth praktikave në parlamentet e tjera në Evropë është i vlefshëm dhe me interes për stafin parlamentar, shkalla deri në të cilën këto përvoja janë përshtatur dhe përkthyer drejt kontekstit specifik të Kosovës përcakton në një masë të madhe rëndësinë e tyre për ndryshimin që pritet të pasojë. Hipoteza jonë e dytë është se sa më shumë ekspertë janë të njohur me kontekstin specifik të Kosovës, aq më mirë ata janë në gjendje të këshillojnë se si të zbatojnë kornizën procedurale apo ligjore parlamentare në vendin e tyre në kontekstin specifik të Kosovës; dhe kështu, më shumë mundësi do të ketë për rezultate të qëndrueshme.

Vlen të theksohet se, siç është rasti në çdo vlerësim të projekteve të qeverisjes, ekziston një sfidë konceptuale për vlerësimin e tri projekteve të binjakëzimit, e që është çështja e atribuimit: deri në çfarë mase mund t'i atribuohet cilësia e funksionimit të parlamentit një ndërhyrjeje nga një projekt? Përvoja në vendet e tjera dhe në projekte të tjera të forcimit parlamentar tregon se as zbatimi i aktiviteteve specifike as shpenzimi i burimeve nuk është domosdoshmërisht ose vetëm me një dimension i lidhur me forcimin e parlamentit. Kjo është kryesisht për shkak të numrit të madh të variablave ndërhyrës në performancën parlamentare. Zgjedhjet nga udhëheqja e vendit dhe vendimet e parlamentit mund të kenë ndikim vendimtar në zbatimin e projektit. Prandaj, nuk ka zëvendësim për politikën me nuanca dhe analiza konceptuale. Kjo është çfarë kemi bërë me këtë vlerësim po ashtu.

Të tri projektet përfshijnë një periudhë të gjatë kohore prej më shumë se 6 vjet, midis 11 nëntorit 2011 dhe 31 marsit 2018. Vlerësimi i këtyre tri projekteve përbënte një mundësi unike për të bërë vëzhgime thelbësore mbi modelin e projekteve të binjakëzimit parlamentar në krahasim me modalitetet e tjera të asistencës teknike për parlamentin.

1.4.2 Qasja gjithëpërfshirëse

Meqenëse programi i financuar nga KE me Kuvendin është kryer në tri faza, ishte e mundur të vlerësohej secila fazë veçmas ose të merrej një pamje më gjithëpërfshirëse. Ne ishim të mendimit se qasja e fundit do të ishte më e mirë pasi që mundëson rishikim më të lehtë dhe më të dobishëm në të gjitha fushat e mbështetjes, shqyrton lidhjet dhe sinergjitë dhe jep konkluzione dhe rekomandime

më kuptimplota lidhur me funksionimin e Kuvendit si institucion i pavarur, me një rol të forcuar të mbikëqyrjes dhe rol në çështjet që lidhen me BE-në. Ku ishte e dobishme, ne u jemi referuar rezultateve specifike dhe aktiviteteve të secilit prej tri projekteve individualisht.

1.4.3 Vlerësimi mbi realizimin e programit

Siç është përmendur në raportin fillestar për këtë detyrë, ne kemi shqyrtuar projektet e Binjakëzimit nën tre tituj kryesorë: projektimi, zbatimi i projektit dhe menaxhimi i projektit. Kjo është struktura e kapitullit të këtij raporti për realizimin e programit.

- Seksioni 'Dizajnimi i projektit' ka analizuar deri në çfarë mase ka pasur bazë solide për zbatimin e projektit dhe ka shqyrtuar rëndësinë, renditjen dhe fushëveprimin e projektit.
- Seksioni "Zbatimi i projektit" ka vlerësuar qasjet kryesore për zbatimin e projektit dhe mënyrën se si aktivitetet kanë kontribuar në objektivat në të tri projektet.
- Seksioni 'Menaxhimi i projektit' ka rishikuar se si janë realizuar mekanizmat e menaxhimit, komunikimit dhe koordinimit të projekteve të binjakëzimit.

1.4.4 Vlerësimi teknik për temat e projektit

Duke vlerësuar ndërlidhjen, efektivitetin dhe efikasitetin e tri projekteve, ne kemi parë shenja të ndikimit dhe qëndrueshmërisë së rezultateve të projektit. Me fjalë të tjera, detyra kryesore e përgjithshme ishte të theksojë dhe të dokumentojë ndikimin e projektit në përmirësimin e funksionimit të administratës së Kuvendit. Duke vepruar kështu, ne kemi vlerësuar fushat kryesore tematike të projekteve dhe kemi analizuar se deri në ç'masë është arritur ndikimi dhe në çfarë mase ka kontribuar ndihma teknike dhe rekomandimet e projekteve në këtë drejtim.

Vlerësimet e ndikimit teknik janë strukturuar në gjashtë kapituj kryesorë tematikë më tej në këtë raport. Vlerësimet teknike për ndikimin e projekteve fokusohen në çështjen e pavarësisë së Kuvendit, procesin legjislativ në Kuvend, praktikat e mbikëqyrjes, funksionimin e administratës, si dhe rolin e Komisioneve dhe i administratës në procesin e integritetit evropian.

1.4.5 Cilësia dhe zbatimi i rekomandimeve

Pasi që hartimi i rekomandimeve ishte pjesë thelbësore e rezultateve të projekteve, ne kemi përpiluar një tabelë vlerësimi të rekomandimeve të projekteve, në veçanti rekomandimet e nxjerra në Planin e Veprimit të projektit të tretë. Tabela e vlerësimit mund të gjendet në shtojcën 5 të këtij raporti.

Së pari, ne kemi vlerësuar cilësinë e rekomandimeve duke matur deri në çfarë mase përmbajtja e secilit prej rekomandimeve është SMART: Specifike, të Matshme, të Arritshme, Relevante dhe Të kufizuara në kohë.

Së dyti, kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të secilit prej rekomandimeve, duke u dhënë atyre një notë në qoftë se ato janë 'bërë', 'pothuajse është bërë', 'filluar', 'shqyrtuar', 'refuzuar' ose nuk ka pasur qartësi për nivelin e zbatimit.

Vlerësimi se deri në çfarë mase zbatimi i rekomandimeve është 'bërë', 'pothuajse është bërë', 'ka filluar', 'shqyrtuar', 'refuzuar' ose nëse nuk ka qartësi, merret parasysh një dokument i përgjithshëm i marrë nga Sekretariati i Kuvendit si intervistat tona të thella, ndonjëherë pasuar nga një intervistë e dytë, me menaxhmentin e Sekretariatit, udhëheqësit e komponentëve dhe ekspertët e zgjedhur të Binjakëzimit.

Vlerësimi na ka mundësuar kështu që të vendosim një përqindje mbi cilësinë dhe zbatimin e paketës së rekomandimeve sipas secilit prej kriterëve.

Ky rishikim i cilësisë dhe zbatimit të rekomandimeve të Planit të Veprimit ka kontribuar në analizën tonë të qëndrueshmërisë së rezultateve të projektit; dhe duke u bazuar në rekomandimet e paraqitura për përkrahje të mëtejshme për Kuvendin e Kosovës, në mënyrë të veçantë në cilën mënyrë "menaxhimi i ndryshimeve" të kërkuara më së miri mund të shoqërohet në Kuvend.

Në një situatë të tillë, ne punojmë sipas Standardeve të Grupit të Vlerësimit të Kombeve të Bashkuara, ku thuhet se *"një vlerësues do të shqyrtojë se çfarë mekanizmesh vlerësues përcjellës ekzistojnë që sigurojnë që rekomandimet e vlerësimit të shfrytëzohen dhe zbatohen në kohën e duhur dhe se gjetjet e vlerësimit janë të lidhura me aktivitetet e ardhshme."*⁶

1.4.6 Mbledhja e të dhënave

Burimi i parë për mbledhjen e të dhënave ishte rishikimi i dokumenteve. Kjo përfshinte raportet përfundimtare, raportet e aktiviteteve, raportet e progresit dhe konkluzionet e Komitetit Drejtues të Projekteve të Binjakëzimit, dokumentet referuese për forcimin e parlamentit, raportet e vlerësimit të projekteve parlamentare në vende të tjera, raportet e vendit nga KE për Kosovën dhe raporte të tjera të analizës mbi qeverisjen në Kosovë.

Një burim i dytë për grumbullimin e të dhënave ishin intervistat e strukturuar me aktorët kryesorë në projekt, si deputetët, sekretari i përgjithshëm dhe stafi i Kuvendit, projekte të tjera të donatorëve me Kuvendin, OSHC-të, ekspertët e binjakëzimit dhe personeli i Zyrës së BE-së në Kosovë. Janë përgatitur një grup specifik pyetjesh për secilin prej këtyre takimeve.

Për aq sa është e mundur, kemi mbledhur informacion kuantitativ mbi punën e Kuvendit në ato fusha të adresuara drejtpërsëdrejti nga aktivitetet e projektit.

1.4.7 Sfidat e vlerësimit

Në fillim të fazës fillestare, janë identifikuar disa supozime dhe rreziqe. Si fundi i vlerësimit, mund të bëhen këto komente mbi këto supozime dhe rreziqe. Së pari, dokumentacioni i projektit është vënë në dispozicion me kohë. Ish udhëheqësit e ekipit dhe ekspertët kryesorë ishin në dispozicion për korrespondencën dhe intervistat përmes Skype. Zyra e BE-së dhe Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës kanë mbështetur vlerësimin duke kontaktuar bashkëbiseduesit kryesorë në Kuvend dhe duke caktuar takime.

Një nga rreziqet e identifikuar ishte disponueshmëria e deputetëve dhe bashkëbiseduesve politikë. Për fat të keq, vetëm tre deputetë ishin në dispozicion gjatë pranisë sonë dy javore në Kosovë. Ndërsa vetë projekti i binjakëzimit po përpiqej të planifikonte takime me deputetët, edhe misioni i vlerësimit u përball me të njëjtën sfidë, pasi që shumë pak deputetë kishin kohën ose zgjedhën të ndajnë kohë për vlerësimin. Hendeku në informata dhe analiza është tejkaluar duke takuar disa nga partnerët ndërkombëtarë në Kuvend ose përmes një takimi të dytë me stafin e zgjedhur të Kuvendit.

⁶ UNEG, Standardet për Vlerësim në Sistemin e OKB-së, fq. 5, http://www.uneval.org/papersandpubs/documentdetail.jsp?doc_id=22

2 Pyetjet dhe përgjigjet e vlerësimit

Bazuar në kriteret e vlerësimit të renditura në TeR, kemi zgjedhur 17 pyetje vlerësimi, nën gjashtë tituj: ndërlidhja, efikasiteti, efektiviteti, ndikimi, qëndrueshmëria, vlera e shtuar e BE-së dhe koherenca. Përgjigjet e hollësishme në lidhje me pyetjet e vlerësimit janë detajuar në dy kapitujt kryesorë të këtij raporti: vlerësimin për ofrimin e programeve dhe vlerësimin teknik mbi temat e programit. Duke marrë parasysh informacionin e hollësishëm në këta kapituj, ky kapitull ofron përgjigje më koncize për 17 pyetjet e vlerësimit.

Ndërlidhja: Vlerësimi se deri në çfarë mase projekti ka adresuar nevojat ekzistuese dhe në ndryshim të Kuvendit të Kosovës dhe sa mirë ka shfaqur projekti një pako koherente të aktiviteteve.

1 Si i janë lidhur të tri projektet me strategjinë e KE-së për Kosovën? Në ç'mënyrë të tri projektet kanë kontribuar apo kanë qenë komplementare me strategjinë e KE-së dhe a ishin perceptuara ato si të tilla nga Kuvendi i Kosovës?

Sapo MSA-ja midis BE dhe Kosovës hyri në fuqi më 1 prill 2016, detyrat u rritën për të gjitha institucionet zyrtare në Kosovë, duke përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës. Instrumentet e MSA-së dhe mbështetja e IPA-s për Kuvendin janë mekanizma shumë të nevojshëm për të punuar drejt reformave politike dhe legjislative, në përputhje me parimin e "çështjet themelore të parat", të cilat përfshijnë institucionet demokratike dhe reformën e administratës publike.

Objektivat e tri projekteve të binjakëzimit lidhen posaçërisht me përafrimin e BE-së dhe zbatimin e praktikave më të mira të BE-së. Projektet synojnë të përmirësojnë kapacitetet legjislative, mbikëqyrëse dhe administrative të Kuvendit, si dhe njohuritë dhe aftësitë lidhur me përafrimin e BE-së dhe një rol më të madh për Komisionin për Integrimin Evropian. Në këtë mënyrë, të tri projektet i kanë kontribuar strategjisë së KE-së për Kosovën. Rëndësia që Kuvendi i jep projektit, lidhet qartë me perspektivën evropiane të Kosovës.

2 Deri në çfarë mase janë SMART rekomandimet drejtuar Kuvendit: Specifike, të Matshme, të Arritshme, Relevante dhe Të kufizuara në kohë?

Rezultati përfundimtar i tri projekteve të binjakëzimit është "Plani i Veprimit për të përmirësuar aktivitetet e Kuvendit për një proces të suksesshëm të integritimit në BE". Dokumenti përmban 224 rekomandime: 178 veprime për nivelin politik dhe 46 veprime për nivelin administrativ të Kuvendit. Si pjesë e këtij vlerësimi, ne kemi vlerësuar se deri në çfarë mase secili prej 224 rekomandimeve është SMART: Specifike, të Matshme, të Arritshme, Relevante dhe Të kufizuara në kohë.

Siç shihet më tej në raport, 66% e rekomandimeve ishin specifike; që do të thotë se 1/3 e numrit të përgjithshëm të rekomandimeve nuk ishin mjaft specifike. Rreth 80% e rekomandimeve ishin të matshme dhe 20% nuk ishin të matshme. Pothuajse 84% e rekomandimeve ishin të zbatueshme dhe 87% mund të konsideroheshin relevante. Çuditërisht, vetëm 18% e rekomandimeve ishin të caktuara me kohë, që do të thotë se mbi 80% e rekomandimeve nuk ishin të caktuara me kohë. Këto shifra duket se sugjerojnë se cilësia e rekomandimeve të projekteve të binjakëzimit ishte mjaft e pa balancuar, megjithëse shumica e tyre kanë cilësi të mjaftueshme.

Në çështjet e shqyrtuara, projekti i binjakëzimit propozoi një rekomandim të vetëm në Kuvend. Një qasje alternative e mundshme do të ishte të jepte dy ose tri opsione, aty ku ishte e dobishme, për të inkurajuar miratimin nga vendimmarrësit në Kuvend. Propozimi i rekomandimeve të vetme në të gjitha rrethanat mund të ketë lënë të paprekur vlerën e shtuar potenciale të ofrimit të mundësive që Kuvendi të shqyrtojë dhe të vendosë.

3 Deri në ç'masë janë përmirësuar ose modifikuar objektivat dhe aktivitetet e projekteve për shkak të ndryshimeve në sektorin apo kushtet e jashtme me qëllim të arritjes së rezultateve të planifikuara?

Pasi që rezultatet e një projekti formuan bazën për projektin e ardhshëm, ekzistonte një renditje e qartë midis tri projekteve. Prandaj, kur realizimi kryesor i projektit të dytë, Ligji për Kuvendin, nuk u arrit, u paraqit nevoja për përshtatje në fillim të projektit të tretë. Ekipi i projektit zhvilloi një pako alternative të aktiviteteve, kryesisht rreth trajnimit të stafit dhe këshillimit në vendin e punës, si dhe rekomandimeve të cilat mund të miratoheshin dhe zbatoheshin pavarësisht nëse do të miratohej apo jo një Ligj për Kuvendin.

Trajnimi i stafit dhe këshillimi në vendin e punës u bazuan në analizën e kapaciteteve dhe VNT-në e përgatitur gjatë fazave të mëparshme të projektit. Temat e trajnimit përfshinin: praktikën më të mira të procedurave legjislative të Shteteve Anëtare të BE-së; organizimin e administratave parlamentare në Shtetet Anëtare të BE-së; funksionimin e komisioneve të përhershme dhe detyrat përkatëse të stafit; funksionet e mbikëqyrjes së Kuvendit. Në këtë mënyrë, objektivat dhe aktivitetet e projektit janë përditësuar ose modifikuar sipas nevojës.

Efikasiteti: Vlerësimi se deri në çfarë mase kontributet e projektit kanë dhënë rezultatet e dëshiruara në mënyrë efikase, me humbje minimale të kohës, burimeve njerëzore, financiare dhe materiale të tjera.

- 4 Sa mirë ka funksionuar partneriteti dhe menaxhimi dhe si janë zhvilluar ato me kalimin e kohës?
- 5 Si ishte përfshirë Kuvendi i Kosovës në menaxhimin e projektit dhe sa efektive ka qenë kjo dhe cilat kanë qenë përfitimet ose vështirësitë me këtë përfshirje?

Kuvendi siguroi hapësirat e kërkuara për personelin afatgjatë dhe afatshkurtër, kontributet njerëzore dhe përzgjedhjen e udhëheqësive të komponentëve, duke nxitur zbatimin efikas dhe në kohë. Mbështetja e tillë në natyrë është një nga parakushtet për një zbatim të lehtë të çdo projekti.

Fillimi i zbatimit ishte i lehtë për secilin nga tri projektet, me takimin zyrtar fillestar të mbajtur me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të Kuvendit Kombëtar të Hungarisë dhe të Kuvendit të Kosovës. Zotimi i fuqishëm dhe pronësia vendore ishin të dukshme në fillim të dy fazave të para të projektit.

Në fillim të projektit të parë dhe të dytë, ekzistonte një partneritet dhe bashkëpunim i fuqishëm mes Kuvendit të Kosovës dhe Parlamentit Hungarez dhe kishte bashkëpunim intensiv midis udhëheqësive të ekipit të institucionit zbatues (Parlamenti Hungarez) dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës.

Gjatë rrjedhës së projektit të tretë, ndërveprimet u bënë më të rezervuara, ndër të tjera për shkak të kërkesës së fortë të institucionit zbatues që Administrata të marrë një qasje tjetër ndaj koordinimit të donatorëve. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Drejtues të marsit 2017 jep një pasqyrë në disa nga tensionet në atë kohë, kur Sekretari i Përgjithshëm "*ngriti çështjen se ai asnjëherë nuk është ftuar nga Zyra e BE-së për ndonjë vlerësim lidhur me projektin. Ai përmendi se ka pasur takime me Ekipit të Binjakëzimit dhe ZBE-së, ku Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nuk ishte ftuar të paraqiste mendimin e tij*".

Një nga instrumentet e rëndësishme të menaxhimit të projektit ishin takimet tremujore të Komitetit Drejtues. Të gjithë udhëheqësive të komponentëve nga pala përfituese dhe bashkëbiseduesit kryesorë nga partneri zbatues ishin të pranishëm. Procesverbalet e detajuara ofrojnë një pasqyrë të mirë për temën e diskutimit. Udhëheqësive të komponentëve miratuan aktivitetet e propozuara dhe paraqitën reagime për cilësinë e iniciativave të kaluara.

Interesante është se një nga sfidat kryesore të projektit ishte përmendur tashmë në raportin përfundimtar të projektit të parë të Binjakëzimit: mungesa e disponueshmërisë së deputetëve dhe udhëheqësive të Kuvendit për të diskutuar dhe angazhuar në rekomandimet e projektit. Procesverbali i mbledhjeve të Komitetit Drejtues siguroi dëshmi se kjo çështje mbetet e pazgjidhur deri në fund të projektit të tretë. Arsyet për këtë janë të shumfishta, duke përfshirë edhe kontekstin e vështirë politik

që absorboi shumicën e energjisë nga deputetët dhe zgjedhjet e parakohshme. Sidoqoftë, meqenëse ishte tashmë një çështje gjatë projektit të parë, rrugët alternative për t'u angazhuar me udhëheqjen politike, ndoshta me ndihmën e Zyrës së BE-së, mund të ishin ndjekur me qëllim të sigurimit të kontributeve dhe miratimit të rekomandimeve kryesore të fokusuara në drejtim të nivelit politik.

6 Deri në çfarë mase mekanizmat e koordinimit me zbatuesit e tjerë kanë lejuar zbatimin efikas të programit?

Si një nga projektet më të mëdha të asistencës në Kuvend, projektet e binjakëzimit kishin kontakte të rregullta me projektet e tjera të donatorëve që punonin në Kuvend, si UNDP, NDI, GIZ, OSBE dhe të tjerë. Intervistat gjatë misionit të vlerësimit ofruan një pamje mjaft të përzier në marrëdhëniet me projektet e tjera të donatorëve. Partneri zbatues i Projekteve të Binjakëzimit konsideron se ka bërë pjesën e vetë duke informuar projekte të tjera të aktiviteteve të tij dhe duke ndarë dokumentet përfundimtare të projektit. Disa nga projektet e tjera të donatorëve kanë theksuar se Projekti i Binjakëzimit kishte zhvilluar një plan shumë të detajuar dhe afatet kohore të aktiviteteve të tij para fillimit të projektit,⁷ gjë që u dha projekteve të tjera përshtypjen se kishte pak hapësirë për reflektim të përbashkët mbi mënyrën më të mirë të qasjes për ecje përpara në kontekstin e vështirë në këtë rast. Gjatë intervistave, projektet e tjera të donatorëve (UNDP dhe OSBE) përmendën se, sapo ata të vunë re se projekti i binjakëzimit mori përgjegjësinë për një fushë të caktuar, ata vendosën të tërhiqeshin, duke lënë këtë iniciativë për projektin e financuar nga BE-ja në ato fusha.

Si pjesë e vlerësimit, ne kemi vërejtur se ka pasur përpjekje për ndarje të punëve sipas pajtimit midis projekteve të donatorëve me synim shmangien e mbivendosjes së panevojshme dhe dyfishimit; ndonëse bashkëpunimi i donatorëve me anë të këshillave të përbashkëta, rekomandimeve të përbashkëta ose aktiviteteve të përbashkëta për ndërtimin e kapaciteteve nuk ka ndodhur.

Udhëheqësi i ekipit të projektit të Binjakëzimit dhe KTR-ja janë të mendimit se Kuvendi duhet të marrë një rol më të fuqishëm në koordinimin e donatorëve dhe të sigurojë që asistencë e njëjtë nuk kërkohet nga më shumë se një projekt i donatorëve. Realiteti është se projektet e ndryshme të asistencës implementojnë atë që selia e tyre e donatorëve i ka porositur të bëjnë. Mënyra e arsyeshme më tej është që agjencitë kryesore të donatorëve - BE, USAID dhe Ambasadat - të diskutojnë planifikimin e tyre afatgjatë dhe shpërndarjen e fondeve përpara fillimit të projekteve, kështu që ka më pak shanse që organizatat të mbesin dhe përpiqen të kapërcejnë dyfishimin mes tyre. [Çështja e marrëdhënieve me projektet e tjera të donatorëve është diskutuar më hollësisht në këtë raport.]

7 Cilët mekanizma të sigurimit të cilësisë ekzistojnë për të arritur rezultatet e planifikuara?

Mekanizmi i parë i sigurimit të cilësisë për realizimin e projektit ishte njohja dhe përvoja e punës së ekspertëve parlamentarë, që vijnë nga 11 parlamentet kombëtare dhe Parlamenti i Evropës. Disa Ekspertë Afatshkurtër (EASH) kishin punuar në Kosovë më parë dhe kishin krijuar marrëdhënie të mira personale me homologët e tyre në Kuvend. Përmbajtja kryesore e vlerësimit të tyre bazë është përfshirë në pesë librat e vlerësimit të projektit të tretë të Binjakëzimit, siç ishte rasti për librat e dy projekteve të para. Gjatë projektit të tretë, EASH-të kanë dorëzuar gjithsej 70 raporte teknike në Kuvendin e Kosovës.

Cilësia e trajnimeve u diskutua në takimet e rregullta midis KTR-së dhe udhëheqësve të komponentëve; dhe u shqyrtua nga Komiteti Drejtues, ku morën pjesë krerët e komponentëve të projektit.

⁷ Është praktikë e rregullt për të gjitha kontratat e KE-së që të ketë një afat kohor të përcaktuar mirë të aktiviteteve që do të zbatohen.

Cilësia e vlerësimeve bazë, trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve dhe shumica e rekomandimeve janë të mira. Për fat të keq, kontrolli i cilësisë së produktit përfundimtar të projektit të tretë, Plani i Veprimit, ishte i shkurtër. Siç është treguar më tej në këtë raport, Plani i Veprimit kishte disa dobësi, në aspektin e strukturës, formatit dhe pjesërisht edhe përmbajtjes së tij po ashtu⁸.

Zyra e BE-së në Kosovë kishte një rol të sigurimit të cilësisë, si donator i projektit, pjesëmarrës në takimet e Komitetit Drejtues dhe bashkëbisedues politik për çështjet e integritimit evropian. Zyra e BE-së kishte besim në ekspertizën e parlamenteve që merrnin pjesë në projekt; megjithëse komunikimi midis Zyrës Politike të BE dhe Projektit të Binjakëzimit mund të ishte më optimal, veçanërisht në lidhje me ndikimin politik të disa prej rekomandimeve dhe lidhur me komunikimin e nevojshëm politik me qeverinë për rëndësinë e mbikëqyrjes efektive parlamentare.

Efektiviteti: Vlerësimi se sa kanë ndikuar rezultatet e projektit në kapacitetin institucional të Kuvendit të Kosovës për t'u bërë institucion demokratik, funksional, llogaridhënës dhe gjithëpërfshirës.

8 Deri në çfarë mase të gjitha grupet e synuara kanë qenë në gjendje të kenë qasje në rezultatet/shërbimet e veprimit?

Administrata e Kuvendit kishte qasje në raportet e vlerësimit dhe rekomandimet e projektit. Udhëheqësit e komponentit morën pjesë në hartimin e aktiviteteve dhe patën takime të rregullta dypalëshe me KTR-të dhe me EASH-të që kanë ardhur.

Ndërkohë që projektet e binjakëzimit kryesisht kanë ndërvepruar me administratën e Kuvendit, ndërveprimi me nivelin politik mund të kishte qenë më i fortë dhe se kryesisht ishte përqendruar tek kryetarët e zgjedhur të Komisioneve dhe një numër i kufizuar takimesh me nënkryetarin dhe kryetarin. Pasi që projektit të tretë i erdhi fundi, pesë librat e vlerësimit dhe Plani i Veprimit u shpërndanë tek të gjithë deputetët, si dhe stafit të Kuvendit.

9 Deri në ç'masë grupet e synuara janë të kënaqur me shërbimet e ofruara?

Udhëheqja e Sekretariatit të Kuvendit bën një dallim të qartë në vlerësimin e saj për rezultatet e projektit të parë, të dytë dhe të tretë. Ndërsa projekti i parë kishte rezultate të qarta, siç konfirmohet nga raporti i vlerësimit të MOR dhe komentet nga stafi i lartë i Kuvendit, rekomandimet e projektit të dytë janë konsideruar të cilësisë së mirë edhe pse nuk mund të zbatohen për arsye politike dhe rezultatet e projektit të tretë u rishikuan me rezerva nga udhëheqja e Sekretariatit të Kuvendit.

Në pyetjen për kënaqshmërinë me shërbimet e projektit, është shfaqur një pamje mjaft e përzier. Duke analizuar procesverbalin nga mbledhjet e komitetit drejtues duket se udhëheqësit e komponentëve janë kryesisht të kënaqur me rezultatet e projektit dhe ndërveprimin e tyre me KTR-të dhe EASH-të. Takimet tona individuale të vlerësimit vënë një nuancë në këtë pamje. Disa bashkëbisedues në kuadër të Sekretariatit të Kuvendit shprehin zhgënjim se çështjet me të cilat ballafaqohen nuk janë zgjidhur, se reformat e kërkuara nuk po ecin përpara apo shumë ngadalë dhe se projekti i binjakëzimit duket se nuk e ka përmirësuar gjendjen. Sidoqoftë, duhet të pranojmë se disa punonjës të Kuvendit kanë shpresa të mëdha që organizata zbatuese do të shtyjë reformat, ndërsa në të vërtetë procesi vendimmarrës për zbatimin e rekomandimeve varet nga vetë Kuvendi.

Pas marrjes së ndihmës nga tri projekte të binjakëzimit, numri i 224 rekomandimeve i befasoi udhëheqësinë e Sekretariatit të Kuvendit, pasi u perceptua si një vlerësim negativ i funksionimit dhe

⁸ Shembuj të dobësive në përmbajtjen e rekomandimeve lidhur me të drejtën e votës në Komisione për deputetët e pa rreshtuar (që mund të ndryshojnë balancën e pushtetit midis shumicës dhe opozitës), caktimin e interpelancave në baza mujore (në një kontekst ku paraqiten shumë pak kërkesa për interpelanca), duke kufizuar kohën në dispozicion të deputetëve për të folur në seancë plenare (e cila ka të ngjarë të dëmtojë deputetët e opozitës) dhe mundësinë që një komision hetues të fillojë punën e tij kur jo të gjitha grupet politike kanë emëruar anëtarët e tyre (gjë që do të paraqiste sfida për kuorum).

kapacitetit të Sekretariatit. Duke u konsideruar si një bombardim me më shumë se 200 rekomandime, Plani i Veprimit ka kontribuar në një marrëdhënie të tensionuar midis partnerit implementues dhe udhëheqjes së Sekretariatit të Kuvendit.

Sidoqoftë, duke shikuar më nga afër në rezultatet e veçanta të projekteve të binjakëzimit, udhëheqësit e komponentëve në Kuvend përgjithësisht pranojnë vlerën dhe cilësinë e vlerësimeve të thella dhe të aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve, duke përfshirë punëtoritë e trajnimit, trajnime, vizita studimore jashtë vendit, praktika, tryeza të rrumbullakëta publike, doracakë, dokumente të përmbledhura, dokumente hulumtuese parlamentare të rishikuara etj.

Ndikimi: Vlerësimi i ndikimit të përgjithshëm të projekteve dhe kontributit të tyre në zhvillimin e Kuvendit të Kosovës (perspektiva afatshkurtër).

10 Cilat janë perspektivat direkte të ndikimit të veprimit?

Në fund të projektit të parë, ndikimi specifik në lidhje me rritjen e kapaciteteve ishte tashmë i dukshëm. Përfituesi miratoi rekomandimet e projektit lidhur me rregulloren për stafin politik dhe një diagram të ri organizativ. Trajnimet dhe turnet studimore kanë forcuar performancën e stafit parlamentar.

Në fund të projektit të tretë, mund të vërehen aspekte të tjera të ndikimit të drejtpërdrejtë. I gjithë stafi është i vetëdijshëm se si parlamentet e vendeve kandidate janë organizuar për të përmbushur sfidën e procesit të përafrimit dhe negociatave me BE-në; dhe kështu, çfarë kërkohet nga Kuvendi i Kosovës të përgatitet në mënyrë të ngjashme.

Shumë bashkëbisedues në Kuvend kanë kuptuar se nëse Kuvendi synon të fitojë autonomi më të madhe nga ekzekutivi, ai duhet të tejkalojë rritjen e kapacitetit të vet administrativ dhe duhet të vendosë procedurat dhe strukturat për të menaxhuar me përgjegjësi buxhetin e vet.

Për integrimin evropian, puna e KIE-së dhe komisioneve të tjera është analizuar mirë dhe rekomandimet për të përmirësuar rolin e Kuvendit në procesin e integritit evropian janë të qarta. Ekziston një propozim i balancuar si të forcohet kapaciteti i Kuvendit për përafrimin ligjor, në aspektin e strukturave, rregulloreve, ekspertizës së kërkuar të stafit.

Dy doracakët legjislativë dhe udhëzimet për hulumtim ofrojnë mbështetje të nevojshme në përmirësimin e cilësisë së asistencës teknike për deputetët.

11 Cilat janë efektet më të gjera dhe ndikimet indirekte të programit?

Megjithëse projektligji për Kuvendin nuk ka të ngjarë të miratohet në formatin aktual, përpjekjet e projektit të binjakëzimit kanë ndikuar në dy mënyra. Së pari, pjesë të projektligjit të propozuar janë përfshirë në projektin e rishikuar të rregullores së punës, veçanërisht në lidhje me organizimin e administratës së kuvendit dhe lidhur me marrëdhëniet midis parlamentit dhe qeverisë për çështjet e integritit evropian. Së dyti, ekziston tani një "fjalor i ndryshimit" në Kuvend dhe një mirëkuptim më i madh në administratën e kuvendit për menaxhim më të mirë publik dhe nevojën për "kontrolle dhe balancime" midis parlamentit dhe qeverisë. Projekti ka vënë çështjen e autonomisë parlamentare në agjendë.

Ndikimi i tërthortë i programit realizohet përmes krijimit të një rrjeti ekspertësh në 11 parlamentet kombëtare në BE, i cili ka potencial për të kontribuar në rolin e Kosovës në diplomacinë parlamentare.

Një tjetër ndikim indirekt i programit është njohja për të kuptuar më mirë sfidën e institucioneve të pavarura. Më konkretisht, ekziston një sqarim i kategorive të organeve të pavarura në kuadër të kompetencave të mbikëqyrjes së Kuvendit dhe harmonizimit me terminologjinë e Kushtetutës; propozime për të përmirësuar procesin e nominimit dhe emërimit të organeve drejtuese dhe ekzekutive të organeve të pavarura; dhe propozimet për të shqyrtuar raportet vjetore të organeve të

pavarura. Për të përfituar plotësisht nga asistenca e ofruar, ekziston nevoja që stafi i Komisionit të ndjek më nga afër rekomandimet e vetë Kuvendit mbi raportet e agjencive; edhe pse një propozim më i detajuar dhe afati kohor për atë se kush duhet të bëjë çfarë dhe si mund të ketë qenë i dobishëm. Nëse pranohet nga Kuvendi, ky propozim do të kontribuojë në forcimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit, cilido të jetë rezultati i saktë për racionalizimin e numrit të agjencive.

12 Si e kanë parë përfituesit kryesorë ndikimin e programit dhe ndryshimet që ka sjellë ai? Si ka ndikuar ai në punën dhe vështrimin e tyre?

Qasja kryesore metodologjike e projekteve të binjakëzimit është të organizojnë aktivitete që kontribuojnë në krijimin e rekomandimeve thelbësore mbi reformat procedurale dhe strukturore në Kuvend, të identifikuar si rezultate të pajtuara në një proces të përbashkët të zbatimit të projektit. Rekomandimet rrjedhin nga vlerësimet fillestare, praktikat më të mira në parlamentet e tjera në Evropë dhe punëtoritë me stafin parlamentar (dhe në një masë të kufizuar edhe deputetët) për të diskutuar vlerësimin bazë, praktikat më të mira dhe draft rekomandimet.

Bazuar në intervistat tona me stafin e lartë të Sekretariatit të Kuvendit, duket se qasja e hartimit dhe shpërndarjes së rekomandimeve nuk është nxitje e mjaftueshme për ndryshim. Menaxhimi i ndryshimeve kërkon më shumë se njohuri se çfarë duhet të ndryshojë, por gjithashtu ka nevojë për një trajektore të këshillimit, ushtrimit dhe avokimit për të zbatuar ndryshimet e propozuara. Modeli dominues i Projekteve të Binjakëzimit, duke gjeneruar rekomandime drejt përfundimit të afatit kohor të projektit dhe duke pritur që institucioni përfitues t'i çojë ato përpara pa mbështetje të mëtejme, duket të ketë pasur sukses të kufizuar. Trajnimi i nevojshëm i këshillimit, përgatitjes dhe avokimit (në veçanti drejt nivelit politik në Kuvend) për të zbatuar ndryshimet e propozuara ka mbetur jashtë afatit kohor të projekteve të Binjakëzimit, të cilat u bënë më të dukshme pas projektit të dytë dhe të tretë.

Rezultati përfundimtar i tri projekteve të binjakëzimit është "Plani i Veprimit për të përmirësuar aktivitetet e Kuvendit për një proces të suksesshëm të integritit në BE". Pikëpamja e udhëheqjes së Sekretariatit të Kuvendit mbi vlerën e këtij dokumenti është shumë e ndikuar nga befasia në numrin e lartë të rekomandimeve si dhe në formatin e dokumentit, pasi vështirë se mund të lexohet si një dokument i pavarur sepse mbështetet në informacione në dokumentet e tjera të projektit (të cilat referohen në një kolonë të veçantë).

Qëndrueshmëria: Vlerësimi i qëndrueshmërisë së rezultateve me fokus të veçantë në kapacitetin kombëtar dhe pronësinë mbi projektin (perspektiva afatgjatë).

13 A kanë qenë në gjendje përfituesit institucional të programit të vazhdojnë me rezultatet e projekteve përtej fazave të programit?

Projekti pritet të arrijë qëndrueshmëri përmes transferimit të njohurive dhe zbatimit të rekomandimeve që priten të avancojnë më tej Kosovën në agjendën e BE-së.

Si pjesë e këtij vlerësimi, kemi shqyrtuar statusin e zbatimit të secilit prej 224 rekomandimeve të Planit të Veprimit. Ne kemi vlerësuar se deri në çfarë mase zbatimi është 'bërë', 'pothuajse bërë', 'ka filluar', po 'shqyrtohet', është 'refuzuar' ose mbetet 'i paqartë'. Bazuar në vlerësimin tonë, më shumë se 7% e rekomandimeve janë zbatuar dhe më shumë se 11% janë pothuajse të zbatuara. Të dyja kategoritë së bashku llogariten për afërsisht 20% të zbatuara ose pothuajse të zbatuara. Për më shumë se 30% të rekomandimeve ka filluar zbatimi. Më shumë se 26% e rekomandimeve janë shqyrtuar edhe pse zbatimi ende nuk ka filluar. Afërsisht 10% e rekomandimeve refuzohen; dhe për 14% të rekomandimeve statusi i implementimit mbetet i paqartë.

Këto shifra konfirmojnë se, megjithëse Kuvendi ka filluar zbatimin e rekomandimeve të projektit të Binjakëzimit, ka nevojë për këshillim dhe përkrahje të mëtejshme në shoqërimin e zbatimit. Kjo në fund do të sigurojë qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura deri tani.

Për qëndrueshmërinë e propozimeve për autonomi parlamentare, është bërë ca përparim drejt qëndrueshmërisë. Ndërsa projekti i binjakëzimit arriti të sjellë Sekretariatit e Kuvendit në bord për rëndësinë e autonomisë parlamentare, duhet të bëhet më shumë punë për të shpjeguar në nivel politik dhe ndaj aktorëve ndërkombëtarë rëndësinë, ndryshimet e nevojshme në kornizën ligjore dhe instrumentet e një parlamenti të fortë dhe të pavarur i cili ka fuqinë dhe aftësinë për të mbikëqyrur qeverinë dhe për të krijuar një udhëheqje llogaridhënëse dhe sistemin e kontrolleve të baraspeshës.

Elemente të tjera që çojnë drejt qëndrueshmërisë janë projekt-rregullorja për riorganizimin e propozuar të Drejtorisë për Standardizimin, Përafrimin dhe Harmonizimin Ligjor në dy njësi; megjithëse ende duhet të vendoset nga Kryesia e Kuvendit. Gjatë intervistave tona të vlerësimit, nuk mund të identifikohet asnjë arsye specifike për vonesën në miratimin e rregullores; dhe prandaj është e arsyeshme të pritet që Kryesia të jetë në gjendje të miratojë rregulloren brenda dy javëve të ardhshme. Cilësia e punës së njësisë të reja do të varet, ndër të tjera, nga respektimi i Kuvendit ndaj rekomandimeve që këshilltarët e rinj për Njësinë e Përafrimit Ligjor flasin rrjedhshëm gjuhën angleze dhe të kenë arsimim në juridik.

14 Deri në çfarë mase mekanizmat e programit sigurojnë që rezultatet e synuara janë të qëndrueshme edhe përtej zbatimit të programit?

Shumë prej rezultateve të synuara janë në rrugën e implementimit, edhe pse kjo do të kërkojë monitorim të mëtejshëm. Për të inkurajuar zbatimin e mëtejshëm të qëndrueshëm, kemi hartuar një listë të shkurtër të veprimeve, të cilat mund të zbatohen lehtësisht, bazuar në analizën përgatitore dhe hartimin e dokumenteve përkatëse. Veprimet në listën e ngushtë janë “pemët e varura ulët” të gatshme të vilen. Kapitulli i fundit me rekomandime përfshin listën e ngushtë të 9 veprimeve që janë të arritshme në dy deri tre muaj të ardhshëm.

Lista e ngushtë përfshin masat lidhur me një njësi të re organizative për çështje të përgjithshme ligjore dhe një njësi organizative për përafrimin ligjor evropian, një njësi të re organizative për koordinimin e çështjeve të integritimit në BE, Strategjinë për bashkëpunim dhe marrëdhënie ndërparlamentare dhe rregullimin e saj, Strategjinë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun (përfshirë seksionin për komunikimin me BE), punësimin e stafit të Njësisë për analiza të buxhetit dhe financave, forcimin e Njësisë për Hulumtime dhe botimin e statistikave të hollësishme, në baza mujore, pyetje gojore dhe me shkrim ndaj qeverisë.

15 Çfarë programimi shtesë është i nevojshëm për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të përfitimeve të vërejtura si rezultat i programit?

Programimi shtesë është i nevojshëm në tri fusha: Në integrimin evropian, mbikëqyrjen parlamentare dhe profesionalizimin e administratës. Në vend që të kryhen vlerësime të reja dhe hartimi i rekomandimeve të reja, ne sugjerojmë që programet shtesë të aplikojnë metodologji të orientuara në praktikë, siç janë ndërtimi i njohurive, ndërtimi i aftësive, mësimi në vendin e punës, mësimi interaktiv, asistencë teknike, vendosja e stafit në një parlament tjetër dhe shkëmbimet rajonale. Propozimet janë të detajuara në kapitullin e fundit të këtij raporti.

Vlera e shtuar e BE-së dhe koherenca: Vlerësimi i masës në të cilën mbështetja e BE-së për Kuvendin e Kosovës shton përfitim për atë që do të kishte rezultuar vetëm nga ndërhyrjet e Shteteve Anëtare dhe koherencën me strategjinë e BE-së për Kosovën.

16 Cila është vlera e shtuar që rezulton nga ndërhyrja e IPA-s në Kuvendin e Kosovës, krahasuar me atë që mund të ishte arritur nga autoritetet e Kosovës pa një ndërhyrje të tillë?

Vlera specifike e shtuar që rezulton nga ndërhyrja e IPA është ekspertiza në praktikën parlamentare nga 11 parlamentet kombëtare dhe rrjeti i ekspertëve që rrjedhin prej kësaj ekspertize. Kjo do të ishte e vështirë për t'u arritur nga Kuvendi pa mbështetjen e ndërhyrjes së IPA-s.

Një vlerë tjetër e shtuar është vendosja afatgjate e stafit në një parlament tjetër, si dhe këshillimi nga stafi i parlamenteve të tjera përtej prezencës së tyre në Kosovë, si për shembull këshillimi për hulumtime për një periudhë më të gjatë kohore.

17 Cilat aspekte të programit mund të përsëriten në tjera vende? Cilat kushte do të kërkoheshin për të prodhuar rezultate?

Disa aspekte të programit mund të përsëriten. Ne do të donim të theksojmë pesë shembuj:

- Korniza ligjore dhe procedurale për ndërtimin e autonomisë parlamentare është një aspekt i programit i cili mund të jetë i rëndësishëm në vende të ndryshme. Mund të jetë e dobishme të qartësohet se çështjet e organizimit të brendshëm të një parlamenti autonom rregullohen përmes Rregullores së Punës ndërsa çështjet e tjera lidhur me përgjegjësinë e parlamentit dhe institucioneve të tjera shtetërore në parlament rregullohen nëpërmjet legjislacionit parësor, duke formuar kështu shkallën e dëshiruar të autonomisë për parlamentin.
- Ofrimi i një procesi të rishikimit të kolegëve të hulumtimeve me të dhëna të departamenteve kërkimore të parlamenteve pjesëmarrëse është një model i mirë i të nxënimit të rriturve.
- Vendosja më e gjatë e stafit në një parlament tjetër shpesh është më e dobishme për t'u mundësuar stafit parlamentar të absorbojë njohuri të reja dhe të inkorporojnë aftësi të reja në krahasim me vizitat studimore të shkurtra 2-3 ditore me programe shumë të kondensuara.
- Analiza mbi rolin e parlamentit në mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura prek sistemin e qeverisjes të çdo vendi dhe ndonjëherë është në kundërshtim me mekanizmat e llogaridhënies demokratike që priten nga institucionet e tjera publike. Puna e bërë nga projektet mund të vlerësohet më mirë duke ofruar një kornizë gjithëpërfshirëse për balancimin e pavarësisë dhe llogaridhënies së institucioneve dhe agjencive të pavarura.
- Strategjia e propozuar për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe bashkëpunimin ndërparlamentar parasheh një kornizë për koordinimin e rolit të parlamenteve në një rrjet ndërkombëtar gjithnjë e më kompleks të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe. Ajo mund të jetë e dobishme për çdo parlament që dëshiron të kontribuojë në diplomacinë parlamentare dhe të shqyrtojë mundësitë për mbikëqyrje në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Duhet të merren parasysh disa kushte për të riprodhuar rezultatet, siç janë marrja e njohurive të thella mbi funksionimin e parlamentit përfitues, kuptimi i marrëdhënieve ndërmjet nivelit politik dhe administrativ në parlamentin përfitues dhe historisë se si kjo marrëdhënie është krijuar, njohuri mbi dinamikën politike që ndikojnë në pranimin e propozimeve nga projektet e tjera të donatorëve me kuvendin, aftësia e ekspertëve për të shkuar më tej për të shpjeguar situatën në parlamentin e tyre kombëtar dhe për të hulumtuar se në çfarë mënyre eksperiencia e tyre është e adaptueshme në kontekstin lokal.

3 Vlerësimi mbi realizimin e programit

Siç tregohet në hyrjen të raportit, ky kapitull do të vlerësojë se si është organizuar realizimi i programit. Kjo do të bëhet në tri seksione: projektimi, zbatimi i projektit dhe menaxhimi i projektit.

3.1 Dizajni i projektit

Në këtë seksion, kemi analizuar se deri në çfarë mase ka pasur bazë solide për zbatimin e suksesshëm të projektit. Kemi shqyrtuar rëndësinë e projektit, përzgjedhjen e instrumentit zbatues, renditjen dhe fushëveprimin e projektit.

3.1.1 Ndërlidhja

Ndërlidhja e projekteve të binjakëzimit nuk vihet në dyshim. MSA-ja ndërmjet BE-së dhe Kosovës ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Paketa e Zgjerimit e KE-së (2016) konfirmoi parimin e "çështjeve themelore të parat", të cilat përfshijnë institucionet demokratike dhe reformën e administratës publike. Instrumentet e MSA-së dhe mbështetja e IPA-s për Kuvendin e Kosovës janë mekanizma të përshtatshëm për reforma politike dhe legjislative. Dizajni i tri projekteve të binjakëzimit duket të jetë i përshtatshëm, pasi që objektivat lidhen qartë me përafrimin e BE-së dhe zbatimin e praktikave më të mira të BE-së. Rezultatet e projekteve synojnë të forcojnë pozitën e Kuvendit të Kosovës brenda kornizës kushtetuese të Kosovës dhe të përmirësojnë kapacitetet legjislative dhe mbikëqyrëse, të forcojnë menaxhimin e burimeve njerëzore, të përmirësojnë kapacitetet për përafrim me legjislacionin, normat dhe standardet e BE-së, të forcojnë rolin e Komisioni për Integritet Evropian dhe për njohuri të zgjeruara të stafit dhe deputetëve për çështjet e Integritetit Evropian dhe acquis-it të BE-së.

3.1.2 Përzgjedhja e instrumenteve zbatuese

Institucioni përfitues ka marrë pjesë aktive në përzgjedhjen e një instrumenti implementimi (binjakëzimi) dhe partnerit të binjakëzimit të Shtetit Anëtar (Parlamenti Hungarez) për projektin e parë dhe të dytë. Kuptohet që për procesin e tenderimit për projektin e tretë kishte vetëm një aplikues (parlamenti hungarez). Praktikisht, procesi i përzgjedhjes nuk kishte konkurrent.

3.1.3 Renditja dhe fushëveprimi i projekteve

Ka pasur një renditje të qartë të tri projekteve, një projekt i ndërtuar mbi rezultatet e projekteve të mëparshme. Kur realizimi kryesor i projektit të dytë, Ligji për Kuvendin, nuk u arrit, u paraqit nevoja për përshtatje në fillim të projektit të tretë. Ky është një shembull i mirë i nevojës për programim përshtatës dhe nevojës për përshtatje të rregullt të programit.

Fiche e Veprimit për Projektet e Binjakëzimit, shpjegimi i fushëveprimit dhe temave të projekteve është hartuar nga Kuvendi duke i shtuar kontributin nga Zyra e BE-së. Pas vlerësimit gjithëpërfshirës të tri projekteve, duket se fushëveprimi i tri projekteve së bashku ishte i gjerë, ndoshta tejet i gjerë. Të tri projektet kanë prekur shumë - ndoshta tepër shumë - çështje të funksionimit parlamentar: rolin dhe funksionimin e departamenteve të ndryshme në administratë, punën e komisioneve, plenaren dhe kryesinë, statusin, procedurat dhe burimet e Kuvendit, procesin e integritetit evropian dhe bashkëpunimin ndërparlamentar. Sigurimi i arritjes së përparimit në shumë fusha ishte detyrë menaxheriale jo e lehtë për t'u përmbushur. Një fushëveprim më i reduktuar i projektit mund të ketë qenë më efikas.

3.2 Zbatimi i projektit

Seksioni "Zbatimi i projektit" ka vlerësuar qasjet kryesore për zbatimin e projektit dhe mënyrën se si aktivitetet kanë kontribuar në objektivat e cekur në të tri projektet.

3.2.1 Vlerësimi i rezultateve

Udhëheqja e bën një dallim të qartë në vlerësimin e saj për rezultatet e projektit të parë, të dytë dhe të tretë. Ndërsa projekti i parë kishte rezultate të qarta, siç konfirmohet nga raporti i vlerësimit të MOR dhe komentet nga stafi i lartë i Kuvendit, rekomandimet e projektit të dytë janë konsideruar të cilësisë së mirë edhe pse nuk mund të zbatohen për arsye politike dhe rezultatet e projektit të tretë u rishikuan me rezerva nga udhëheqja e Sekretariatit të Kuvendit. Rrjedhimisht, ka një ndryshim në vlerësimin e rezultateve të projektit të tretë të binjakëzimit ndërmjet partnerit implementues dhe përfituesit.

Megjithatë, për të qenë i drejtë, procesi i vendimmarrjes lidhur me pagat dhe beneficionet e deputetëve është një dilemë që edhe parlamentet e tjera kanë hasur dhe vazhdojnë të luftojnë me të; kështu që kjo pyetje shkon më larg sesa vetëm te Kuvendi i Kosovës. Prandaj, çështja e pagës së deputetëve nuk ishte fokusi i projektligjit për Kuvendin dhe projekti i binjakëzimit bëri zgjedhjen e duhur për të mos e përfshirë këtë çështje në fushëveprimin e projektligjit të propozuar.

Në vend të një Ligji mbi Kuvendin, praktikat më të mira ndërkombëtare tregojnë se ka disa qasje të tjera alternative për të rregulluar çështjen e pagave të deputetëve. Kemi mësuar se Qeveria ka përgatitur një projekt-ligj mbi pagat për zyrtarët publikë, i cili përfshin çështjen e pagave për deputetët dhe projektligji ka kaluar leximin e parë në Kuvend.

Si përmbledhje, ndërsa projekti i binjakëzimit arriti të sjellë Sekretariatit e Kuvendit në bord për rëndësinë e autonomisë parlamentare, duhet të bëhet më shumë punë për të shpjeguar në nivel politik dhe ndaj aktorëve ndërkombëtarë rëndësinë dhe instrumentet e një parlamenti të fortë dhe të pavarur i cili ka fuqinë dhe aftësinë për të mbikëqyrur qeverinë dhe për të krijuar një sistem të përgjegjshëm të qeverisjes.

4.2 Legjislacioni në Kuvendin e Kosovës

Ky kapitull diskuton rezultatet dhe propozimet e projekteve të binjakëzimit në fushën e legjislacionit dhe përafrimit ligjor dhe nxjerr në pah rekomandimet kryesore dhe statusin e tyre aktual.

4.2.1 Procesi legjislativ në parlament

Me qëllim të përmirësimit të procedurës legjislative në kuvend, projektet e Binjakëzimit sugjeruan modifikime në Rregulloren e Punës së Kuvendit (RReP). Propozimet u diskutuan dhe u morën në shqyrtim në grupin parlamentar të punës që rishikoi RReP-në, duke marrë parasysh edhe sugjerimet e partnerëve të tjerë, kryesisht NDI. Nga pikëpamja e vlerësimit, ne po theksojmë këtu tri rekomandime kryesore nga projekti i binjakëzimit lidhur me procesin legjislativ në parlament.

Një propozim i parë i binjakëzimit lidhej me kornizën e nevojshme kohore për hapat procedural dhe përgatitjen adekuate të takimeve të komisioneve dhe leximet. Projekti i parë i binjakëzimit propozoi ndarjen e votimit mbi ndryshimet dhe votimin përfundimtar për tërë projektligjin në dy seanca plenare të njëpasnjëshme. U argumentua se kjo do të lejonte kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e efektit të amendamenteve të miratuara në përmbajtjen e plotë të projektligjit. Gjatë misionit të vlerësimit u informuam se grupi i punës nuk e pranoi këtë propozim, pasi u konsiderua se do të shkaktonte shumë vonesa në miratimin e legjislacionit.

Një propozim i dytë i projektit të binjakëzimit ishte të kërkonte mendimin e qeverisë mbi projekt-amendamentet e shqyrtuara nga kuvendi para votimit. Ky sugjerim nuk është pranuar nga deputetët, për shkak të shqetësimeve për vonesat në kohë dhe paqartësisë mbi atë se cila do të ishte vlera e shtuar.

Një propozim i tretë lidhet me faktin se aktualisht katër komisione kryesore janë të obliguara të shqyrtojnë tërë legjislacionin, përfshirë Komisionin e Integritetit Evropian. Pranohet se kjo krijon një ngarkesë të madhe pune për komisionin, në veçanti pasi që pjesa e legjislacionit të rishikuar nuk

prekë çështjet e integritit evropian. Prandaj, projekti i parë i binjakëzimit vlerësoi se katër komisionet kryesore duhet të caktohen vetëm për të shqyrtuar një projektligj dhe ndryshimet e tij nëse fushëveprimi i tij bie nën kompetencat e komisionit; dhe kështu Komisioni për Integritet Evropian duhet të shkarkohet nga detyra e obligueshme për të shqyrtuar të gjithë legjislacionin, siç sugjerohet gjatë projektit të tretë të Binjakëzimit. Kuptohet që ky propozim nuk është marrë në shqyrtim as nga grupi i punës për RReP.

Në shkurt të vitit 2018, Komisioni i Kuvendit përfundoi punën e tij për rishikimin e RReP-së. RReP-ja e rishikuar e propozuar ka përmirësuar dhe avancuar RReP-në aktualisht në fuqi (të miratuar në vitin 2010) në disa fusha. Shqyrtimi ynë paraprak i rregullave të rishikuara të propozuara gjithashtu tregon se ato përfshijnë të meta të konsiderueshme, boshllëqe dhe paqartësi që mund të pengojnë funksionimin efikas të Kuvendit dhe të ndikojnë në mirëkuptimin e përbashkët të kërkesave për funksionimin demokratik të Kuvendit. Pa synuar kryerjen e një shqyrtimi gjithëpërfshirës të RReP-së të propozuar e të rishikuar, kemi identifikuar gjashtë fusha me prioritet për sqarim:

- 1 Leximi i parë i një projektligji mund të fillojë dy ditë pas shpërndarjes së projektligjit tek deputetët: ky është një afat kohor shumë i shkurtër, i cili nuk lejon ndonjë përgatitje domethënëse nga deputetët ose grupet parlamentare. Periudha prej pesë ditëve të punës duhet të jetë minimumi absolut. (neni 66.1).
- 2 Rishikimi i projektligjeve dhe propozimi i amendamenteve nga një Komision drejtuar Komitetit të Raportimit parasheh një afat kohor prej dy javësh pas miratimit në parim në leximin e parë. Afati i tillë i shkurtër kohor nuk mundëson ndonjë proces domethënës të shqyrtimit nga Komisionet, ku përfshihen konsultime me publikun, shoqërinë civile dhe ekspertët e jashtëm. (neni 68.3)
- 3 Përgatitja ose miratimi i versioneve të konsoliduara të ligjit nuk përmenden.
- 4 Procedurat e Kuvendit lidhur me përafrimin ligjor me Acquis-in e BE-së, puna e bërë nga Komisioni i Integriteteve në BE dhe Departamenti për Përafrimin Ligjor nuk përmenden dhe meritojnë një nen të veçantë në Kapitujt X-XI.
- 5 Seksionet e mëdha të kapitullit mbi bashkëpunimin ndërmjet kuvendit dhe qeverisë në lidhje me çështjet e integritit evropian nuk janë çështje e organizimit të brendshëm të Kuvendit dhe prandaj duhet të jenë objekt i legjislacionit primar dhe jo i RReP-së së Kuvendit (Kapitulli XVI).
- 6 Pyetjet parlamentare: Do të ishte e dobishme të shtohet një dispozitë që në faqen e internetit dhe Buletin e Kuvendit të publikohen, në mënyrë lehtësisht të qasshme dhe të kërkueshme, të dhënat statistikore të pyetjeve me gojë dhe me shkrim, përgjigjet e dhëna me kohë dhe përgjigjet e dështuara, transkriptimi fjalë për fjalë i pyetjeve dhe përgjigjeve me gojë dhe teksti i pyetjeve dhe përgjigjeve me shkrim. (neni 82 dhe 83.)

Duket e mençur dhe e dobishme të shqyrtojmë çështjet e lartpërmendura dhe verifikimin e gjuhës/përkthimit të dokumentit, para se të votohet përfundimisht për RReP-në e re.

Një numër i konsiderueshëm i reformave të propozuara nga projekti i binjakëzimit varen nga mundësia e Kuvendit për të u pajtuar për ndryshimet në RReP. Miratimi i ndryshimeve në RReP kërkon një shumicë prej 2/3 të deputetëve, ku kërkohen votat e 80 prej 120 deputetëve. Kuptohet që Komisioni për Legjislacion ka miratuar projekt-ndryshimet në RReP, megjithatë ky vendim është marrë me shumicë votash (partitë e opozitës LDK dhe VV kanë abstenuar) e jo me konsensus siç do të ishte e dëshirueshme për një dokument aq të rëndësishëm sa RReP. Një mbledhje e kohëve të fundit e seancës plenare të Kuvendit ka treguar se është e mundur për partitë e shumicës dhe të opozitës që të gjejnë baza të përbashkëta për çështjet që konsiderohen me rëndësi kritike për të ardhmen e Kosovës (siç është Forca e Sigurisë e Kosovës).

Për të mbështetur funksionimin e përmirësuar të Kuvendit, tani dhe në mandatin e ardhshëm, mund të themi se - në parim - ndryshimet në RReP meritojnë pajtimin e përbashkët të partive qeverisëse

dhe të opozitës. Ne sugjerojmë që Kuvendi të shqyrtojë gjashtë fushat me prioritet të lartpërmendura për sqarime dhe të bëjë verifikimin e gjuhës/përkthimit të dokumentit, para se të votohet përfundimisht për RReP-në e re. Shpresojmë që shqyrtimi i gjashtë fushave me prioritet do të ndihmojë në lehtësimin e një miratimi të orientuar në konsensus për RReP-në e re.

4.2.2 Dokumentimi qeveritar i projektligjeve

Parakushti i rritjes së cilësisë së legjislacionit në fazën parlamentare është cilësia e projektligjeve të paraqitura nga qeveria. Dispozitat përkatëse të Rregullores së Punës, kompleksiteti i çështjeve të projektligjeve në përgjithësi, si dhe obligimet e Kosovës që rrjedhin nga MSA-ja lidhur me fushat ku Kosova gradualisht do të harmonizojë sistemin e saj ligjor me *acquis-in* e BE-së kërkon paraqitjen e një shpjegim gjithëpërfshirës me arsyetime të përgjithshme dhe të hollësishme mbi projektligjin e propozuar nga qeveria. Prandaj, kuvendit duhet t'i sigurohen dokumente më të bazuara për shqyrtimin e projektligjeve, një memorandum shpjegues gjithëpërfshirës dhe - në lidhje me përafrimin ligjor evropian - informacione të detajuara mbi detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja dhe tabela e përputshmërisë.

Projekti i Binjakëzimit pohon se në praktikë, dokumentet që shoqërojnë projektligjet shpesh nuk përmbajnë informacionet thelbësore për fushëveprimin dhe qëllimin e projektligjit, apo për kornizën rregullatore të lëndës. Përveç kësaj, mendimet e ndryshme të ministrive u bashkëngjiten projektligjeve në vend të një pozicioni të unifikuar qeveritar. Prandaj, vullneti dhe synimi i qeverisë si sponsor i projektligjit mbetet i paqartë në pika specifike. Ky fenomen shkakton probleme gjatë tërë procedurës legjislative.

Projekti i Binjakëzimit pohon që Kuvendit duhet të i ofrohen dokumente më të bazuara për shqyrtimin e projektligjeve. Projekti rekomandoi që kuvendi të refuzojë projektligjet që nuk kanë memorandum shpjegues gjithëpërfshirës.

Nga pikëpamja e vlerësimit, ne pajtohemi me këtë rekomandim, ndonëse nuk kemi marrë asnjë informacion konkret se kuvendi ka marrë këtë sfidë dhe po ushtron autoritetin e vet në këtë çështje. Kur është diskutuar rishikimi i RReP-së, Departamenti Ligjor sugjeroi një ndryshim të rregullit që kryetari i kuvendit të ketë të drejtën e kthimit të një projektligji që nuk i plotëson kërkesat e lartpërmendura. Në pritje të miratimit të RReP-së së rishikuar, rregulla aktuale mbetet në fuqi, gjë që përcakton se seanca plenare në tërësi duhet të vendosë që të mos vazhdojë me një projektligj pas leximit të tij të parë, për shembull për shkak të mungesës së dokumenteve shpjeguese gjithëpërfshirëse. Deri më tani, seanca plenare nuk ka marrë asnjë vendim në këto linja në tri vitet e fundit.

4.2.3 Deklarata e harmonizimit dhe Tabelat e Pajtueshmërisë

Sipas MSA-së, qeveria e Kosovës është e detyruar të sigurojë që projektligjet e paraqitura në Kuvend të shoqërohen me një deklaratë mbi harmonizimin me *Acquis*, si dhe tabelën e pajtueshmërisë.

Kemi mësuar se në praktikë, deklaratat mbi harmonizim shpesh është e paqartë, duke pohuar se projektligji është plotësisht ose pjesërisht i harmonizuar me *Acquis* pa ofruar shumë shpjegime apo justifikime. Tabelat e pajtueshmërisë së qeverisë nuk përkthehen në shqip dhe serbisht, prandaj nuk janë dokumente zyrtare. Na është thënë që tabela e pajtueshmërisë është shpesh jo e plotë, mungon informacioni se në çfarë niveli ka arritur përafrimi i ligjit, arsyet për të dhe afatet përkatëse.

Përveç kësaj, tabela e pajtueshmërisë nuk ofrohet në gjuhën shqipe dhe serbe, por vetëm në anglisht, dhe kështu nuk mund të konsiderohet si dokument zyrtar.¹⁴

Ekspertët e projektit diskutuan këtë çështje disa herë me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE) dhe me Zyrën e Kryeministrit (ZKM); por çështja ka mbetur e pazgjidhur.

Nga pikëpamja e vlerësimit, ne u përpoqëm ta diskutojmë këtë çështje me Departamentin Ligjor të MIE-së dhe me Zyrën Koordinuese në ZKM, por asnjë prej tyre nuk ishte në dispozicion për një takim. Cilësia e deklaratave të harmonizimit dhe tabelave të pajtueshmërisë na duket një çështje kritike për vëmendje nga Zyra e BE-së ose ndonjë projekt i financiar nga BE-ja me MIE-në dhe ZKM-në; dhe përtej fushëveprimit të projektit të Binjakëzimit me kuvendin.

Përveç kësaj, projekti i Binjakëzimit rekomandoi që kuvendi të mbajë tabelat e pajtueshmërisë në një bazë të dhënash elektronike, të qasshme për të gjithë stafin në kuvend. Aq sa dimë ne, kjo çështje është ende në proces.

4.2.4 Njësia për përafrimin e legjislacionit me Acquis-in e BE-së

Paralelisht me përmirësimin e procedurës legjislative, duhet të forcohet kapaciteti i administratës së kuvendit për të siguruar mbështetje cilësore për procesin legjislativ. Për këtë qëllim, projekti i parë i binjakëzimit sugjeroi krijimin e një njësie të veçantë për detyrat e kodifikimit dhe harmonizimit të projektligjeve përgjatë tërë procesit legjislativ. Projekti i tretë i binjakëzimit sugjeroi që Drejtoria për Standardizimin, Përafrimin dhe Harmonizimin Ligjor të ristrukturohej dhe të punojë në mënyrë të konsiderueshme me juristët e specializuar në fusha të ndryshme legjislative dhe fusha të acquis-it të BE-së. Projekti i tretë i binjakëzimit sugjeroi që brenda kësaj drejtorie të krijohet një njësi e re organizative përgjegjëse për çështjet e përgjithshme ligjore dhe kodifikim për të mbështetur punën legjislative gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurës legjislative dhe se një njësi organizative e veçantë të jetë përgjegjëse ekskluzivisht për përafrimin e ligjit me acquis-in e BE-së përgjatë gjithë procedurës legjislative brenda të njëjtës drejtori.

Njësia e re organizative përgjegjëse për çështjet e përgjithshme ligjore dhe kodifikimin do të ishte përgjegjëse për të mbështetur analizën ligjore të projektligjeve dhe të amendamenteve, si dhe punën legjislative gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurës legjislative. Njësia e re organizative gjithashtu do të korrigjojë tekstin e projektligjeve të propozuara për miratim në leximin e dytë dhe do të kryejë të gjitha detyrat lidhur me shpalljen dhe publikimin e ligjeve të miratuara. Me themelimin e njësisë së re përgjegjëse për çështjet e përgjithshme ligjore dhe kodifikim nën Drejtorinë për Standardizimin, Përafrimin dhe Harmonizimin Ligjor, Njësia aktuale për Përafrimin dhe Harmonizimin Ligjor do të ishte përgjegjëse ekskluzivisht për përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis-in e BE-së përgjatë gjithë procedurës legjislative. Mbajtja e praktikës aktuale, Njësia për Standardizim do të kryejë të gjitha detyrat lidhur me legjislacionin shumëgjuhësh.

Projekti i Binjakëzimit ka përgatitur një projekt-rregullorë për riorganizimin e propozuar të Drejtorisë për Standardizimin, Përafrimin dhe Harmonizimin Ligjor në dy njësi; megjithëse ende duhet të vendoset nga Kryesia e Kuvendit. Gjatë intervistave tona të vlerësimit, nuk mund të identifikohet asnjë arsye specifike për vonesën në miratimin e rregullores; dhe prandaj është e arsyeshme të pritet që Kryesia të jetë në gjendje të miratojë rregulloren brenda dy javëve të ardhshme.

¹⁴ Megjithatë, neni 54 i RReP-së - Kushtet për paraqitjen e një projektligji - parashikon që Projektligji i paraqitur në kuvendit duhet të përmbajë: paragrafin 1, pika c) "Deklaratën për përafrimin dhe harmonizimin me legjislacionin e BE-së dhe me tabelën e akteve të cilës i referohet". Ndërsa paragrafi 2 përcakton që "Çdo projektligj i paraqitur në kuvend do të hartohet në gjuhët e mëposhtme: Shqip, serbisht dhe anglisht, në letër dhe në formë elektronike". Kjo tregon se qeveria është e detyruar të dërgojë në kuvend tabelat e pajtueshmërisë në gjuhët zyrtare të Kosovës: Shqip, serbisht si dhe në anglisht.

Projekti i Binjakëzimit këshilloi që ndryshimet e lartpërmendura të kërkojnë ripërkufizimin e detyrave të Drejtorisë së riorganizuar për Standardizimin, Përafrimin dhe Harmonizimin Ligjor dhe Drejtorinë për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare gjatë fazave të ndryshme të procedurës legjislative. Kuptohet që projekti i binjakëzimit ka përgatitur përshkrimet e rishikuara të vendeve të punës, megjithëse ende nuk janë miratuar.

Projekti ka rekomanduar që këshilltarët e rinj ligjorë për Njësinë e Përafrimit Ligjor të Kuvendit duhet të flasin rrjedhshëm gjuhën angleze, kështu që ata kanë kapacitetin për të analizuar tabelat e pajtueshmërisë të paraqitura në gjuhën angleze, si dhe çdo dokument tjetër të Acquis-it dhe nga BE që është në gjuhën angleze. Gjatë takimeve tona të vlerësimit, kemi mësuar se procesi i rekrutimit për këshilltarët e ri ligjor është në vazhdim. Duket e rëndësishme për ne që kuvendi tu përmbahet plotësisht kërkesave të rekomanduara që stafi i ri të ketë diplomë universiteti në juridik dhe të flasë rrjedhshëm gjuhën angleze; pasi kjo do të demonstrojë që kuvendi investon në rolin e tij profesional në verifikimin e përafrimit ligjor.

Sapo të jetë rekrutuar stafi i ri dhe të jetë bërë riorganizimi, do të ketë nevojë për trajnim të specializuar dhe transferim të njohurive për kapitujt e ndryshëm të MSA-së. Kjo mund të jetë një fushë e rëndësishme e ndihmës së mundshme të ardhshme të BE-së për kuvendin.

4.2.5 Konsolidimi i legjislacionit

Përgatitja e një teksti të konsoliduar të projektligjit me amendamentet e miratuara në seancën plenare është mjet shumë i rëndësishëm për cilësinë legjislative.

Çështja u diskutua gjerësisht me stafin e kuvendit gjatë projektit të Binjakëzimit Ligjor. Është vërejtur se në disa vende evropiane konsolidimi ligjor është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë, Gazetës Zyrtare, Komisionit Parlamentar të Legjislacionit ose sponsorit të Ligjit. Projekti i Binjakëzimit prezanton mënyra të ndryshme se si zbatohet në vende të ndryshme të BE-së.

Bazuar në diskutimet me stafin e kuvendit, projekti i tretë i binjakëzimit ka rekomanduar që kuvendi të marrë rolin udhëheqës në konsolidimin e legjislacionit. Më saktësisht, projekti sugjeroi që të redaktohej një version i konsoliduar i ligjit pas futjes së amendamentit të tretë dhe nëse më shumë se 20% e tekstit të tij ndryshohet me amendamente.¹⁵ Projekti rekomandoi që versioni i konsoliduar i ligjeve të botohet gjithashtu në Gazetën Zyrtare.

Projekti rekomandoi që komisioni përgjegjës për legjislacion të analizojë tekstin e konsoliduar të projektligjit me qëllim që të propozojë eliminimin e çdo shkalle të mundshme të mospërputhjes dhe se analiza e këtij komisioni kufizohet në propozimin e eliminimit të mospërputhjeve terminologjike ose ligjore në tekst ose kur bien ndesh dispozitat e projektligjit dhe dispozitat e tjera të sistemit ligjor. Projekti gjithashtu sugjeron që përgatitja e versionit të konsoliduar të ligjit të modifikuar të bëhet nga Njësia e Shërbimeve Ligjore; dhe se përgatitja e versioneve në shqip, serbisht dhe anglisht të ligjit të konsoliduar të bëhet nga Njësia e Standardizimit Gjuhësor.

Gjatë intervistave tona të vlerësimit, stafi i lartë i kuvendit shpjegoi hezitimin e tyre se si të vazhdojnë më tutje. Pyetjet mbeten nëse versioni i konsoliduar i ligjit duhet të konsiderohet si version zyrtar ose si version në përdorim dhe nëse duhet të krijohet versioni i shtypur ose versioni elektronik, duke marrë parasysh që legjislacioni në Kosovë botohet në pesë gjuhë. Në të njëjtën kohë duhet të kuptohet se çështja e konsolidimit legjislativ kërkon një kuptim të përbashkët të të gjithë aktorëve relevantë, duke përfshirë qeverinë, kuvendin, gjykatat, ekspertët ligjorë etj. dhe se do të jetë e vështirë për kuvendin të zgjidhë çështjen i vetëm.

¹⁵ Ka nevojë për sqarime të mëtejshme se si do të matet 20% bazuar në numërimin e fjalëve ose në substancën/përmbajtjen?

Ndërsa shumica e bashkëbiseduesve tanë duket se pajtohen se konsolidimi i legjislacionit është i rëndësishëm, është bërë e qartë se asnjë sistem ende nuk është miratuar; dhe nuk duket se ka ndonjë proces në drejtim të konsultimit të mëtejshëm dhe marrjes së vendimeve për këtë çështje.

4.2.6 Praktika e miratimit të përshpejtuar të legjislacionit

Gjatë takimeve tona të vlerësimit, stafi i lartë i kuvendit ngriti çështjen e praktikës së vazhdueshme të miratimit të përshpejtuar të legjislacionit nga ana e kuvendit. RReP në fuqi përmban një nen i cili përcakton se me 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm dhe me votim (61 deputetë duhet të marrin pjesë në votim) mund të vendosin të anashkalojnë RReP-në. Kjo do të thotë se 41 nga 61 deputetët e pranishëm dhe që votojnë mund të vendosin të anashkalojnë RReP-në, e cila përdoret si mekanizëm për miratim të përshpejtuar të legjislacionit, nganjëherë duke caktuar leximin e parë dhe të dytë të projektligjeve në të njëjtën ditë ose me shumë pak kohë ndërmjet. Është vërejtur se ekziston një anomali në rregullat, pasi që 41 deputetë mund të vendosin të anashkalojnë RReP-në, por një shumicë prej dy të tretash të deputetëve (80/120) është e nevojshme për të ndryshuar RReP-në.

Në kuadër të grupit të punës që rishikon RReP-në, Departamenti Ligjor ka përgatitur projekt-amendamentet e RReP-së ku theksohet se vetëm në rrethana shumë të veçanta do të ishte e mundur të anashkalohej RReP-ja.

Projekti i Binjakëzimit ka hezituuar të japë këshilla se si dhe kur mund të përdoret miratimi i përshpejtuar i legjislacionit, sepse procedura legjislative e rregullt tashmë ka dobësi të konsiderueshme (shih komentet e mësipërme mbi dokumentet shoqëruese) dhe afatet tashmë të shkurtra për shqyrtimin e projektligjeve. Praktika e miratimit të përshpejtuar të legjislacionit është vërejtur si çështje shqetësuese në raportet e progresit të KE-së/raportet e vendit që kanë qenë më parë.

Nga pikëpamja e vlerësimit, ne e kuptojmë qëndrimin e pakëndshëm të kuvendit ndaj shqetësimeve në raportet e progresit të KE-së/raporteve të vendeve sepse miratimi i përshpejtuar nganjëherë ka ndodhur për shkak të presionit nga institucionet ndërkombëtare dhe misionet diplomatike në lidhje me obligimet ndërkombëtare të Kosovës. Ndërkohë që komuniteti ndërkombëtar ndonjëherë i ka bërë presion kuvendit për të vijuar me legjislacionin më shpejt (ndonjëherë për shkak se qeveria nuk ka dorëzuar legjislacionin në kohën e duhur siç ishte rasti në lidhje me IPA), nuk është shumë konsistente të kritikohet kuvendi në raportet e progresit të KE-së për përdorimin e procedurës së përshpejtuar. Sidoqoftë, një procedurë e tillë është praktikë e keqe parlamentare, sepse pengon konsultimet publike dhe shqyrtimin e hollësishëm parlamentar. Prandaj është për t'u lëvdur që kuvendi synon të kufizojë këtë praktikë në propozimin e tij për rishikime në RReP.

4.2.7 Sistemi i gjurmimit të legjislacionit

Me qëllim të rritjes së transparencës së legjislacionit dhe efikasitetit të veprimtarisë legjislative, projektligji, ndryshimet dhe dokumentet që mbështesin procedurën legjislative duhet të jenë të arritshme përmes parlamentit elektronik (e-parlamenti) dhe sistemit të ndjekjes legjislative.

Bazuar në propozimet e projektit të parë dhe të dytë të binjakëzimit, sistemi i përcjelljes së legjislacionit është tashmë i disponueshëm dhe i arritshëm në faqen e internetit të kuvendit. Për fat të keq, në praktikë, ky i fundit nuk përdoret plotësisht pasi dokumentet nuk ngarkohen në sistem në mënyrë sistematike. Sipas rekomandimeve për zhvillimin e sistemit të e-parlamentit, ngarkimi i dokumenteve duhet të bëhet i detyrueshëm. Duket e këshillueshme që më shumë mekanizma të zbatimit janë të dobishëm, duke përfshirë lidhjen e vlerësimit të performancës së stafit me përdorimin e plotë të sistemit të përcjelljes.

4.2.8 Funksionimi shumëgjuhësh i kuvendit

Praktika ndërkombëtare nga parlamentet e tjera shumëgjuhëshe ka treguar se ekipet e vogla të përbëra nga stafi ligjor dhe përkthyesit që punojnë ngushtë së bashku në projektligjet që nga paraqitja e tyre në kuvend deri në miratimin përfundimtar të tyre sigurojnë saktësinë gjuhësore të të gjitha teksteve të ndryshme të përpunuara gjatë përgatitjes së amendamenteve dhe garantojnë më tej koherencën e dokumenteve në gjuhë të ndryshme. Projekti i Binjakëzimit rekomandon që kapaciteti administrativ të forcohet duke siguruar trajnim të rregullt në përkthimin ligjor për të gjithë ata që ndërhyjnë në procesin legjislativ.

Gjatë takimeve tona të vlerësimit, stafi i lartë në Departamentin Ligjor ka propozuar që qeveria të lëshojë certifikatë mbi harmonizimin gjuhësor dhe konsistencën për të gjitha projektligjet e paraqitura në Kuvend. Ishte befasuese të mësojmë që një certifikatë e tillë nuk është duke u lëshuar nga qeveria.

Për më tepër, projekti i binjakëzimit rekomandoi përgatitjen nga Kuvendi dhe Qeveria të një "fjalori të termave ligjorë" të përditësuar vazhdimisht në gjuhët zyrtare. Qëllimi i tij është të garantojë një shkallë më të lartë të qartësisë dhe koherencës në përkthimin e drafteve, ndryshimeve dhe teksteve të dërguara për shpallje.

Nga pikëpamja e vlerësimit, vihet në projektet e tjera të donatorëve (siç është Misioni i OSBE-së në Kosovë) kanë përgatitur një fjalor në aspektin parlamentar dhe ligjor për Kuvendin e Kosovës disa vite më parë; dhe kështu rekomandimi për të përgatitur një fjalor të përditësuar vazhdimisht mund të avancohet duke ndërtuar më tej mbi punën e investuar në fjalorin e përpiluar nga projekte të tjera.

4.2.9 Dy doracakë legjislativë

Për të mbështetur stafin ligjor në Kuvend, projekti i tretë i Binjakëzimit ka përgatitur doracakun për analizën ligjore dhe përgatitjen e dokumenteve që mbështesin procedurën legjislativë dhe Doracakun për Përafrimin Ligjor Evropian dhe përgatitjen e dokumenteve që mbështesin procedurën legjislativë.

Të dy doracakët përshkruajnë në detaje një analizë ligjore hap pas hapi të projektligjeve dhe ndryshimeve, si dhe metodën e përafrimit ligjor evropian në çdo fazë të procedurës legjislativë. Ato gjithashtu fokusohen në mënyrën se si të paraqiten rezultatet e analizave ligjore dhe të shqyrtimit të transpozimit të ligjit të BE-së në dokumente të ndryshme që mbështetin procedurën legjislativë. Kjo është përmbajtje e shkurtër.

Doracaku mbi analizën ligjore dhe përgatitjen e dokumenteve që mbështesin procedurën legjislativë	Doracaku për përafrimin ligjor evropian dhe përgatitjen e dokumenteve që mbështesin procedurën legjislativë
<ul style="list-style-type: none"> • Verifikimi formal i kërkesave për paraqitjen e projektligjit <ul style="list-style-type: none"> ○ Analiza e projektligjit dhe përgatitja e raportit paraprak ○ Analiza e pajtueshmërisë me hierarkinë e normave ligjore ○ Analiza e koherencës së brendshme të hartimit të ligjeve ○ Analiza e përmbajtjes së projektligjit dhe përgatitja e rezymesë • Raporti i Komisionit dhe rekomandimet për projektligjin në leximin e parë • Formulimi i ndryshimeve 	<p>Analiza e projektligjit dhe përmbajtjes së raportit paraprak</p> <p>Lokacioni bazë i projektligjit në sistemin e ligjit të BE-së</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cila prej katër lirive është/janë afektuar? (Shënoni të gjitha ato që vlejnë) 2. Cilët kapitull të acquis-it të BE-së i përket propozimi (siç është listuar në MSA)? 3. Propozohet harmonizim i pjesshëm, i plotë apo mos harmonizim? 4. A është projektligji i lidhur me ligjet e tjera në fuqi apo projektligjet që duhet të miratohen në të ardhmen që duhet të zbatohen së bashku për të arritur harmonizimin e plotë?

<ul style="list-style-type: none"> • Analiza e amendamenteve dhe përgatitja e opinionit ligjor dhe raporteve të komisionit <ul style="list-style-type: none"> ○ Analiza e pajtueshmërisë me hierarkinë e normave ligjore ○ Analiza e qëllimit dhe fushëveprimi i amendamentit ○ Analiza e përmbajtjes dhe konsistencës së amendamenteve ○ Analiza e vendit të futjes së amendamentit ○ Analiza e gjuhës juridike të amendamentit • Raporti – duke përfshirë tabelën krahasuese me tri kolonat – përgatitur nga komisioni i angazhuar para leximit të dytë 	<p>5. Shënoni pesë fjalë kyçe që përshtaten më mirë me këtë propozim nga këndvështrimi i ligjit të BE-së.</p> <p>Marrëdhëniet specifike për masa të caktuara të ligjit të BE-së</p> <p>6. Cilat pjesë të legjislacionit dytësor të BE-së transpozohen me këtë propozim?</p> <p>7. A ka ndonjë rregullore ligjore të propozuar që është më kufizuese sesa ato që gjenden në pjesët e legjislacionit dytësor të BE-së?</p> <p>8. A ka ndonjë rregullore të propozuar që është më pak kufizuese sesa ato që gjenden në pjesët e legjislacionit dytësor të BE-së?</p> <p>9. A ka ndonjë rregull që përmban ndihmën shtetërore?</p> <p>Nene specifike që kërkohen për të qëndruar i paprekur</p> <p>10. Listoni të gjitha nenet (kapitujt, titujt, nëntitujt) e projektligjit që janë të lidhura ngushtë me transpozimin e acquis-it të BE-së dhe që kërkohen të qëndrojnë të pandryshuara për të siguruar transpozimin e duhur të së drejtës së BE-së.</p> <p>11. Listoni të gjitha nenet (kapitujt, titujt, nëntitujt) e projektligjit që nuk janë në përputhje me ligjin e BE-së dhe duhet të ndryshohen për transpozimin e duhur.</p> <p>Analiza e ndryshimeve dhe përmbajtjes së opinionit ligjor mbi përafrimin ligjor evropian</p> <p>Vlerësimi i neneve dhe ndryshimeve nga këndvështrimi i ligjit të BE-së</p>
---	--

Si pjesë e këtij vlerësimi, ne kemi shqyrtuar përmbajtjen e doracakëve në hollësi. Ne kemi konstatuar se të dy doracakët janë gjithëpërfshirës, të hollësishëm, të shkruara në mënyrë të qartë dhe metodologjikisht të strukturuar mirë. Ato mund të përdoren nga të gjithë anëtarët përkatës të stafit të administratës së Kuvendit si mjet udhëzues në aktivitetin e tyre të përditshëm profesional. Ato mund të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së legjislacionit përmes analizave të thella dhe përpunimit të materialeve adekuate mbështetëse para takimeve dhe leximeve të komisioneve në seancat plenare. Gjatë takimeve tona, stafi ligjor ka konfirmuar se ata herë pas here i konsultojnë doracakët.

4.3 Menaxhimi financiar, in BNJ-së dhe TIK-ut në Kuvendin e Kosovës

Sistemet e menaxhimit financiar dhe buxhetor dhe burimeve njerëzore si dhe TIK-ut janë aspektet më të rëndësishme të funksionimit të institucioneve buxhetore. Propozimet dhe ngritja e kapaciteteve të ofruara gjatë projektit të parë dhe të dytë të Binjakëzimit formuan bazën për rekomandime gjatë projektit të tretë të Binjakëzimit. Duke pasur parasysh mos-miratimin e ligjit për Kuvendin, projekti i tretë i Binjakëzimit përshtati qasjen e tij në lidhje me aktivitetet në këtë fushë.

Gjatë intervistave tona të vlerësimit u përmend se administrata e Kuvendit ka fituar forcë dhe njohuri gjatë gjashtë viteve të fundit dhe se proceset e saj janë përmirësuar. Përdorimi më i mirë i planeve vjetore dhe strategjike (hartimi më i hollësishëm dhe monitorimi më i rregullt i progresit të arritur) do të ofronte një vizion të konsoliduar dhe transparencë mbi ndryshimet që duhet të ndërmerren për të rritur më tej funksionimin e administratës së Kuvendit.

4.3.1 Menaxhimi financiar dhe buxhetor

Në fushën e menaxhimit financiar dhe buxhetor, projekti i parë i binjakëzimit bëri një vlerësim të mirë dhe paraqiti propozime solide për përmirësimin e menaxhimit të buxhetit të Kuvendit. Si rezultat, praktikat e raportimit të buxhetit gjatë gjashtë viteve të fundit janë përmirësuar. Gjatë projektit të dytë të binjakëzimit, u përgatit një rregullore për menaxhimin e buxhetit dhe decentralizimin.

Gjatë projektit të tretë, trajnimet dhe konsultimet u përqendruan në decentralizimin e buxhetit si një instrument i menaxhimit të mirë publik që do të rriste efikasitetin përmes delegimit të përgjegjësisë në menaxhimin e Kuvendit. Natyra e decentralizimit të buxhetit në çdo institucion është që të ndahet buxheti në pjesë ku secila prej tyre lidhet ngushtë me një grup të përcaktuar mirë të rezultateve, të dalave dhe aktiviteteve dhe i delegon pjesët tek një bartës i caktuar buxhetor. Mbajtësi i buxhetit udhëheq procesin e planifikimit të buxhetit dhe mban përgjegjësinë për menaxhimin efektiv dhe efikas të mjeteve buxhetore. Të gjithë bartësit e buxhetit janë ende përgjegjës ndaj kreut të institucionit (zyrtari kryesor administrativ). Kreu i institucionit mbetet përgjegjës i përgjithshëm për buxhetin e institucioneve dhe zbatimin e tij. Shërbimet e auditimit të brendshëm, Zyrtari Certifikues dhe Drejtoria për Prokurim do të mbeten shërbime të përbashkëta. Për të filluar procesin në Kuvend, projekti i Binjakëzimit sugjeroi një pilot projekt për decentralizimin e buxhetit, i cili, nëse vlerësohet pozitivisht, mund të zgjerohet më vonë.

Nga pikëpamja e vlerësimit, projekti i binjakëzimit për decentralizimin buxhetor ballafaqohet me dy sfida. Së pari, decentralizimi i autoritetit mbi çështjet financiare është rritur gjatë shumë viteve në demokracitë parlamentare të vendosura në Evropë dhe kjo është një praktikë e re e menaxhimit që nuk është ushtruar më parë në Kuvendin e Kosovës. Për ta zbatuar me sukses do të kërkojë një proces të menaxhimit të ndryshimeve në kulturën administrative, proces i cili kërkon mbështetje dhe këshillim.

Së dyti, ndërsa aktorët përkatës në administratën e Kuvendit duket se kanë kuptuar dhe miratuar propozimet për decentralizimin e buxhetit, nuk ka asnjë indikacion se ky është rasti për vendimmarrësit aktualë në këtë çështje: Kryesia e Kuvendit dhe Ministria e Financave. Ndërsa eksperti i binjakëzimit është i bindur se Kuvendi ka kapacitetin për të zbatuar propozimin e decentralizimit dhe na ka siguruar që është në përputhje me rregullat e menaxhimit financiar dhe kontrollit të Ministrisë së Financave, kemi mësuar se Ministria e Financave ka shprehur disa rezerva mbi propozimin e decentralizimit të buxhetit; edhe pse nuk e kanë refuzuar atë në mënyrë të hapur. Pasi që Kuvendi ka një kod buxhetor brenda buxhetit të Kosovës, decentralizimi financiar nënkupton krijimin e kodeve për drejtoritë e ndryshme të Sekretariatit; dhe kjo do të kërkonte avokim të mëtejshëm tek Thesari.

Duket se mbështetja e qeverisë, niveli i vendimmarrjes politike në Kuvend dhe akterët ndërkombëtarë me ndikim ende duhet të fitohet nëse propozimi për decentralizimin e buxhetit do të zbatohet.

Sa i përket menaxhimit të prokurimit publik, projekti i Binjakëzimit përpunoi një draft rregullore që mbulon tri fazat kryesore në prokurim, përkatësisht planifikimin e prokurimit, procedurën e prokurimit dhe menaxhimin e kontratave. Projekt rregullorja përcakton përgjegjësitë në secilin prej hapave kryesorë të proceseve të prokurimit (duke përfshirë nënshkrimin e specifikimeve të prokurimit), ka përshkruar se si të përgatisë një parashikim të prokurimit dhe sugjeroi një fillim të hershëm të përpilimit të dosjes së tenderit. Gjatë projektit të tretë të Binjakëzimit, u ofruan disa trajnime për prokurim për të gjithë menaxherët e kontratave.

Rregullorja është hartuar nën supozimin se do të zbatohet pas miratimit të Ligjit për Kuvendin. Eksperti i binjakëzimit i cili e përgatiti draftin e rregullores na siguroi se rregullorja mund të nxjerrët edhe në bazë të legjisllacionit ekzistues, me ndryshime të vogla edhe nëse nuk miratohet Ligji për Kuvendin. Ai theksoi se miratimi i Projektligjit të Propozuar të Prokurimit për Projektin e Binjakëzimit

do të jetë në përputhje me Ligjin mbi Prokurimin, Rregullat mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe proceset e sektorit publik në Kosovë.

Si pjesë e këtij vlerësimi, kemi mësuar se rregullorja e propozuar për prokurimin është plotësuar me komente dhe rezerva nga Ministria e Financave dhe kështu nuk ka shkuar më tej. Kjo rikonfirmon nevojën për angazhim dhe avokim me Ekzekutivin dhe Kryesinë e Parlamentit, nëse reformat e propozuara të projektit të Binjakëzimit duhet të zbatohen.

Ndërkohë, ekziston nevoja për praktika më efikase, pasi kemi mësuar se në dy vitet e fundit projektet e mëdha të prokurimit në Kuvend (për shembull në sektorin e TIK-ut) nuk janë përfunduar me sukses dhe se proceset e prokurimit rinisen rregullisht.

Nga pikëpamja e vlerësimit, është e qartë që nëse Kuvendi synon të fitojë autonomi më të madhe nga ekzekutivi, ai duhet të bëjë më shumë se sa vetëm të rrisë kapacitetin e tij administrativ. Duhet të argumentojë bindshëm se ka procedura dhe struktura në fuqi për të menaxhuar me përgjegjësi buxhetin e vet. Një koncept i rënë dakord mbi decentralizimin e buxhetit, përmirësimin e rregulloreve dhe praktikave të prokurimit, programet e përditësuar softuerike mbi financat dhe strukturën e përmirësuar të raportimit mbi buxhetin dhe shpenzimet do të ndihmojnë në demonstrimin e gatishmërisë së Sekretariatit të Kuvendit për autonomi fiskale.

4.3.2 Burimet njerëzore

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (MBNj) ka qenë prioritet për të tri projektet e Binjakëzimit. Gjatë projektit të parë dhe të dytë janë përgatitur vlerësime dhe rregullore që synojnë forcimin e autonomisë së Kuvendit në MBNj, duke përfshirë klasifikimin e pozitave dhe proceseve të rekrutimit. Projekti i parë i binjakëzimit sugjeroi që të krijohet një lidhje e qartë mes strategjisë organizative dhe përgjegjësive dhe detyrave të punonjësve individualë. Është thënë se ka nevojë për një rekrutim të duhur dhe transparent të bazuar në meritat dhe përmbushjen e kërkesës për një pozitë të caktuar¹⁶, dhe në të njëjtën kohë personeli i rekrutuar duhet të trajnohet në mënyrë të vazhdueshme, bazuar në një strategji trajnuese afatgjatë (tri-pesë vjeçare).

Pasi që Ligji për Kuvendin nuk është miratuar dhe në pajtim me ligjin për shërbimin civil (2010), Ministria për Administratë Publike mbetet përgjegjëse për klasifikimin e titujve të vendeve të punës dhe pozitave në të gjitha institucionet publike, duke përfshirë Kuvendin. Titujt dhe pozitat e propozuara të punës shqyrtohen nga një komision që përfshin zyrtarë të Ministrisë së Financave, Administratës Publike dhe të tjerë.

Gjatë gjithë punës së vlerësimit, shumica e stafit të lartë të Kuvendit shprehën rregullisht qëndrimin se Ministria e Administratës Publike nuk respekton autonominë e Kuvendit. Megjithatë Ligji për Administratën Shtetërore përcakton që Kuvendi është organ kushtetues, i cili nuk është nën qeveri, na është thënë se Ministria ushtron autoritetin e saj për funksionimin e brendshëm të Kuvendit përmes vendimeve të tij për të zgjedhur ose për të mos zgjedhur titujt e propozuar të punës. Ne u informuam se Drejtorja për Personelin e Kuvendit ka dërguar tetë Përshkrime të Punës për klasifikim në Ministri, por u pranua vetëm një pozitë (pozita e SP të Kuvendit). Pozitat e propozuara të koordinatorit të komisioneve parlamentare u refuzuan pasi që këto poste nuk ekzistojnë në katalogun e Ministrisë dhe Kuvendi është i vetmi institucion shtetëror që ka komisione. Meqenëse procesi i miratimit bazohet në parashtrësit elektronike, refuzimet ishin të bazuara në sistem; dhe Drejtorja e

¹⁶ Vlen të përmendet se ndërhyrja politike në procesin e punësimit është theksuar nga disa raporte të progresit/raporte të KE-së mbi Kosovën. Kjo është një sfidë e jashtme për të zbatuar plotësisht rekomandimet e projektit të Binjakëzimit, dhe një çështje e brendshme që pengon MBNj-në e duhur.

Personelit nuk kishte mundësi të merrte pjesë në asnjë mbledhje rishikimi dhe as nuk u ftua për të justifikuar nevojën për këto pozita.

Gjatë projektit të tretë, ekspertët e binjakëzimit zhvilluan një vlerësim të nevojave për trajnim (VNT) të të gjithë stafit të Sekretariatit, i cili është bazë për strategjinë e trajnimit të Kuvendit. Sipas rregullave të zbatueshme, menaxhimi i aktiviteteve trajnuese është përgjegjësi e Drejtorisë për Personelin. Brenda Drejtorisë për Personel, ekziston Njësia për Trajnimin dhe Zhvillimin e Burimeve Njerëzore. Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa është përgjegjëse për menaxhimin administrativ të buxhetit të alokuar për aktivitetet e trajnimit. Zyrtari i Lartë për Koordinimin e Donatorëve dhe Marrëdhëniet me Shoqërinë Civile po vepron si ndërlidhës me donatorët relevantë që ofrojnë programe trajnimi. Strategjia vjetore e trajnimit e Kuvendit përgatitet në bazë të vlerësimeve individuale të stafit, që zhvillohen në fund të çdo viti. Kjo strategji e trajnimit duhet të bazohet në një Plan Strategjik shumëvjeçar të Kuvendit.

Si pjesë e këtij vlerësimi mësuam se iniciativat për ndërtimin e kapaciteteve të shumicës së projekteve të donatorëve me Kuvendin nuk janë në përputhje me strategjinë e trajnimit. Duket se nevojitet më shumë punë për të siguruar që rezultatet e trajnimeve të lidhen me prioritetet e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe vlerësimin e performancës së stafit në Kuvend.

Në qershor të vitit 2016, projekti i tretë i binjakëzimit përgatiti gjithsej dhjetë rekomandime për të përmirësuar proceset e burimeve njerëzore, në përputhje me kornizën ligjore ekzistues. Bazuar në diskutimin tonë me Drejtorin e ri të Drejtorisë për Personelin, në vijim është një vlerësim i shkurtër deri në ç'masë këto dhjetë rekomandime janë në rrugën e duhur për zbatim.

Nga pikëpamja e vlerësimit, pamja e përgjithshme është mjaft e përzier: asnjë nga rekomandimet nuk është zbatuar plotësisht; katër rekomandime janë në proces të zbatimit (6, 1, 2, 7); katër rekomandime janë shqyrtuar por ende nuk ka filluar implementimi (3, 5, 9, 10) dhe dy rekomandime janë refuzuar (4, 8). Në vijim janë rekomandimet (të përmbledhura në titull) dhe komentet e vlerësimit mbi zbatimin e tij.

1 Sistemi i planifikimit të karrierës

Vendet e lira të punës shpallen së pari përbrenda kuvendit, gjë që kontribuon në zhvillimin e brendshëm të karrierës. Sidoqoftë, pavarësisht nga këshilla e projektit të Binjakëzimit, Departamenti i Burimeve Njerëzore ende ka nevojë për propozime më konkrete se si saktësisht të ngrisë një sistem të planifikimit të karrierës.

2 Sistemi i planifikimit të vazhdimësisë

Njëjtë sikurse më lart; Departamenti i Burimeve Njerëzore ende ka nevojë për propozime më konkrete se si saktësisht të ngrisë një sistem të planifikimit të vazhdimësisë.

3 Koordinimi dhe planifikimi i trajnimit dhe zhvillimit të kompetencës

Përkundër këshillave të projektit të Binjakëzimit, Departamenti i Burimeve Njerëzore shprehu nevojën për mbështetje më konkrete në identifikimin e prioriteteve të trajnimit strategjik dhe si t'i përkthejë ato tek partnerët e jashtëm të Kuvendit duke ofruar ndërtimin e kapaciteteve. Aktualisht, duket se ka pak ndërveprim ndërmjet personelit të personelit përgjegjës për koordinimin e trajnimit dhe partnerëve të jashtëm që ofrojnë trajnime.

4 Decentralizimi dhe buxheti për trajnim

U vendos që të mos e ndjekim këtë rekomandim të projektit të Binjakëzimit, sepse programet e trajnimit tashmë janë shumë të decentralizuara, përmes programeve të ndryshme mbështetëse për Kuvendin. Nëse buxheti i vetë trajnimit i Kuvendit do të decentralizohej, pamja e përgjithshme do të ishte edhe më e copëzuar. Rekomandimi - bazuar në një praktikë në parlamentet e tjera -

është konsideruar joadekuat në Kuvendin e Kosovës, pasi që përpjekjet kanë nevojë të bëhen bashkë për trajnim e jo të bëhet decentralizimi i tyre.

5 Mbajtja e evidencave adekuate të trajnimit të organizuar dhe të ofruar

Ekziston një vlerësim i nevojave për trajnim, që është kryer nga personeli individual dhe departamentet; por nuk ka asnjë lidhje me trajnimin aktual të ofruar, të cilat ofrohen në baza ad hoc. Prandaj është shumë vështirë të mbahet evidenca adekuate të trajnimeve të organizuara dhe të ofruara.

6 Përgjegjësia e Departamentit të BNj-së për përmbajtjen e BNj-së në rrjetin e brendshëm të Kuvendit

Rregulloret dhe shumica e formularëve janë në dispozicion në intranet. Megjithatë mundësia për të ngarkuar më shumë informacione të BNj-së në rrjetin e brendshëm varet nga projekti e-parlamenti, i cili është ende në fazë të tenderimit.

7 Përditësimi dhe finalizimi i Përshkrimeve të Punës në katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil

Siç është përmendur më lart, Ministria për Administratë Publike klasifikon Përshkrimet e vendeve të punës në katalogun e vet; dhe Kuvendi nuk ka qenë aq i suksesshëm në sigurimin e miratimit të vendeve të propozuara të punës me kohë.

8 Shkëmbimi i studimit krahasues të projektit të binjakëzimit për praktikën e BNj-së me Ministrinë e Administratës Publike

Nuk është bërë dhe nuk ka plane të veçanta të bëhet një gjë e tillë.

9 Takimet e rregullta ndërmjet stafit të Kuvendit dhe stafit të MAP-së

Kur DL për Administratën Shtetërore, Shërbimi Civil apo Pagat ishte përgatitur nga Ministrin e Administratës Publike, askush nga Kuvendi dhe BNj e tij nuk ishin ftuar në grupet punuese. Nuk ka takime të rregullta ndërmjet stafit të Kuvendit dhe stafit të MAP-së

10 Hapat për të reduktuar kohën e nevojshme për të rekrutuar njerëzit, format e thjeshta të autorizimit, raportimi i afërt për të gjithë hapat e rekrutimit.

